



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE

Plani Strategjik për Zhvillimin Institucional
të
Komitetit për Pakicat Kombëtare
2023 – 2026

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtesa	3
I. Konteksti Strategjik	6
Hyrje dhe qëllimi i dokumentit	6
1.1 Komiteti për Pakicat Kombëtare	7
1.1.1 Veprimtaria e deritanishme, para dhe pas reformës.....	7
1.1.2 Analiza e situatës	9
Përfundime dhe rekomandime.....	15
1.2 Plani Strategjik 2023 – 2026.....	18
1.2.1 Synimi.....	18
1.2.2 Skema e qëllimeve strategjike	18
1.2.3 Metodologjia	19
1.3 Korniza Ligjore	23
1.3.1 Kuadri Kombëtar	23
1.3.2 Kuadri Ndërkombëtar	28
1.3.3 Lidhja me Dokumentet Strategjik	33
1.4 Korniza Institucionale.....	36
II. Planifikim Strategjik	37
2.1 Vështrim i Përgjithshëm mbi Planifikimin Strategjik	37
2.1.1 Konteksti Normativ dhe Shoqëror – Misioni dhe Vizioni.....	37
2.1.2 Qëllimet Strategjike, Objektivat Specifike dhe Masat për Zbatimin e Strategjisë	38
III. Zbatimi, Raportimi, Monitorimi dhe Llogaridhënia	42
3.1 Strukturat përgjegjëse	42
3.2 Mekanizmat e monitorimit	42
3.3 Raportimi i Progresit	42
3.4 Vlerësim i Progresit	42
3.5 Treguesit e Rezultateve dhe Performancës	42
IV. Plani i Veprimit dhe Buxhetimi i Aktiviteteve.....	46
V. Bibliografia	47
VI. Shtojca 1: Lista e detajuar e aktiviteteve të zhvilluara nga KPK-ja pas ristrukturimit të marsit 2021 ..	50

Shkurtesa

AMA	Autoriteti i Medias Audiovizive
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
CERD	Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racial
DKBDPP	Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave që u përkasin Pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore
ECRI	European Commission against Racism and Intolerance (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (I Këshillit të Evropës)
FRA	Fundamental Rights Agency (Agjencia e të Drejtave Themelore) të Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
IT	Specialit i Teknologjisë së Informacionit
KDF	Konventës për të Drejtat e Fëmijëve.
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KEGJRP	Karta Europiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave.
KiE	Këshilli i Evropës
KKMPK	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
KNDKP	Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KPK	Komiteti për Pakicat Kombëtare
KSHM	Komiteti Shtetëror i Minoritete
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSZHI	Plani Strategjik për Zhvillimin Institucional
PR	Marrëdhëniet me Publikun (Public Relations)

RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Ndihmës
ShQK	Shkolla Qendër Komunitare
SKZHIE III	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030
TEU	Traktati i Bashkimit Evropian
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVAP	Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare

Grupi i Punës për ‘Hartimin e Planit Strategjik për Zhvillimin Institucional të Komitetit për Pakicat Kombëtare 2023-2026’ përbëhet si më poshtë:

Sead Kazanxhiu, Nënkyetar i Komitetit për Pakicat Kombëtare

Erion Xhaibra, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Rome

Hasimin Keci, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Boshnjake

Marjana Felah, Përfaqësuese e Pakicës Kombëtare Maqedonase

Marinko Cullafiq, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Malazeze

Llazo Kucuqi, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Greke

Arjan Lile, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Egjiptiane

Pavlo Jakoja, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Serbe

Milena Selimi, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Bullgare

Margit Jica, Përfaqësues i Pakicës Kombëtare Arumune

Eda Koshovari, Drejtor në Drejtorinë e Analizave dhe Projekteve

Genti Koti, Përgjegjës Sektori në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Estela Peshkëpia, Koordinatore, Specialiste në Drejtorinë e Analizave dhe Projekteve

Joni Pashaj, Koordinator, Specialist Jurist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Grupi i punës u asistua nga ekspertët Bujar Taho, Elona Dhëmbo, dhe Erinda Xhaferaj, mbështetur nga projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, ‘Fuqizimi i mbrojtjes nga diskriminimi në Shqipëri’. Kontribut në këtë proces dha edhe ekspertja Irene Kaösaar, caktuar nga OSBE, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare.

Dokumenti është produkt i grupit të punës dhe ekspertëve të angazhuar dhe nuk përfaqëson në ndonjë mënyrë pikëpamjet e Këshillit të Evropës, Bashkimit Evropian, apo Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare.

I. Konteksti Strategjik

Hyrje dhe qëllimi i dokumentit

Të drejtat e pakicave kombëtare në Shqipëri janë pjesë përbërëse e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Qeveria shqiptare në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 konsideron dialogun, mirëkuptimin dhe diversitetin kulturor si kushte të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe stabilitetin e vendit.

Në këtë kuadër, është përmirësuar korniza ligjore dhe ajo e politikave publike për mbrojtjen e pakicave kombëtare, pjesë e të cilës është miratimi në tetor 2017 i ligjit kuadër, Ligj Nr. 96/2017 'Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë', dhe hartimi i akteve nënligjore, të cilat mundësojnë vënien në zbatim të ligjit kuadër. Përmes këtyre masave synohet mundësimi i ushtrimit të të drejtave specifike të njeriut për çdo person që i përket një pakice kombëtare, si një tregues thelbësor për garantimin e mosdiskriminimit dhe barazisë së plotë para ligjit në një shoqëri të integruar. Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore është realizuar përmes konsultimit me përfaqësues të pakicave kombëtare në Shqipëri si dhe me institucione partnere e organizata ndërkombëtare. Hartimi i ligjit kuadër mbi pakicat kombëtare, reflekton standardet ndërkombëtare dhe veçanërisht ato të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës, Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare, si dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare. Krahas përmirësimit të të drejtave të njeriut, si një detyrim ndaj qytetarëve të vet, përmirësimi i kornizës ligjore për pakicat kombëtare përbën edhe një hap domethënës në përmbushje të angazhimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër dhe procesi i integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.¹

Në vijim të këtij reformimi, në janar 2023 u krijua një grup pune me urdhër të Kryetares së KPK-së.² Qëllimi i këtij grupi pune është të hartojë një plan strategjik për zhvillimin institucional të KPK-së. Grupi i punës ka në përbërjen e tij si përfaqësues nga secila prej nëntë pakicave kombëtare të njohura derimëtanisht ashtu edhe punonjës të administratës dhe mbështetës nga tre ekspertë vendas, të angazhuar nga Këshilli i Evropës, si dhe një eksperte ndërkombëtare, e angazhuar nga OSBE, Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare.

Mbi këtë bazë, Plani Strategjik identifikon qartë vizionin, qëllimet strategjike, objektivat, dhe masat specifike të cilat kontribuojnë drejtpërsëdrejti në forcimin institucional të KPK-së. Synimi i këtij plani është të orientojë përmbushjen e misionit ligjor të KPK-së, në përputhje me standardet europiane dhe veçanërisht Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Për më tepër, Plani Strategjik, përmes fuqizimit institucional të KPK-së, synon të kontribuojë në krijimin e një kulture demokratike ku diversiteti kulturor i pakicave kombëtare nuk shihet si një arsye për veçim apo përjashtim. Kështu, plani vendos theksin tek ruajtja dhe promovimi i kulturës dhe traditave të pakicave si një pjesë integrale e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

Në këtë vështrim, bashkëpunimi i ngushtë ndërinstitucional mes KPK-së dhe gjithë institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, autoriteteve ligjzbatuese, qytetarëve dhe komuniteteve të pakicave kombëtare, organizmave joqeveritare publike e private, dhe mediat është thelbësor. Kjo qasje ndërinstitucionale bashkëpunimi është një garanci më shumë për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe zhvillimin e kulturës dhe traditave të tyre.

¹ Për më tepër shih Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2023 (SKZHI III), Rev.28Oct22, faqe 32.

² Urdhër dt. 27/01/2023 i Kryetares së KPK-së për krijimin e grupit të punës për përgatitjen e planit strategjik.

Së fundi, Plani Strategjik për Zhvillimin Institucional të Komitetit për Pakicat Kombëtare synon përparimin e mëtejshëm drejt zbatimit efektiv të kornizës ligjore, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale të KPK-së, një prej strukturave shtetërore ku marrin pjesë edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të nëntë pakicave kombëtare, të njohura me ligj në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Komiteti për Pakicat Kombëtare

1.1.1 Veprimtaria e deritanishme, para dhe pas reformës

Komiteti për Pakicat Kombëtare (KPK) është një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, krijuar me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ky Komitet është krijuar me ligjin nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Komiteti përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari dhe 9 anëtarë të cilët përfaqësojnë pakicat kombëtare të njohura me ligj, ku përfshihen pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

Komiteti ka autoritetin të nxjerrë rekomandime, opinione, dhe propozime drejtuar organeve shtetërore për marrjen e masave të veçanta për pakicat, veçanërisht përsa i takon përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë të drejtat dhe liritë e personave që u përkasin pakicave. Gjithashtu, Komiteti është i autorizuar t’i propozojë organeve të pushtetit, qendror dhe vendor, masat e mundshme dhe konkrete për përmirësimin e situatës dhe përmbushjen e të drejtave të pakicave kombëtare. Komiteti për Pakicat Kombëtare zëvendësoi Komitetin Shtetëror të Minoriteteve (KSHM), i cili ishte krijuar me akt-nënligjor në mars 2004.³

Që nga krijimi, KSHM, nën drejtimin e znj. Kostantina Beziani, ka dhënë kontribut domethënës në mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare si dhe në hartimin e raporteve të ndryshme dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes së pakicave. Në mënyrë të përmbledhur këto përfshijnë:

- Raportin fillestar mbi zbatimin e Konventës kundër Diskriminimit Racial (CERD)
- Raportin e ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues)
- Raportin e RSH-së për monitorimin e zbatimit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
- Raportin e Monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2005-2015; 2016-2020; 2021-2025
- Raportin Kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik (UPR)
- Raportin Kombëtar për “Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor”
- Raportin mbi Opinionin e Katërt dhe të Pestë për zbatimin e Konventës Kuadër për Minoritetet nga ana e Republikës së Shqipërisë
- Raportin “Profili Arsimor Gjuhësor të Shqipërisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës ku një kapitull më vete ka zënë dhe gjuha e minoriteteve. Gjatë periudhës prill – maj 2016, KSHM ka marrë pjesë aktive në takimet e Grupit të Punës të ngritur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për këtë qëllim.
- RTSH-ja, prej dhjetorit 2016, nisi fillimisht transmetimin e urimeve të fundvitit në gjuhët e pakicave dhe më pas edhe rubrikat e lajmeve, traditë e cila vijon.

³Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 127, datë 11.03.2004. Gjatë periudhës 2004-2017 njiheshin zyrtarisht dy kategori minoritetesh: (a) minoritetet etno-kombëtare, ku përfshiheshin minoritetet grek, maqedonas, dhe serbo-malazez; si dhe (b) minoritetet etno-gjuhësore, ku përfshiheshin minoritetet vllah dhe rom. Ligji 96/2017 hoqi kategorizimin duke njohur nëntë komunitetet si pakica kombëtare.

- KSHM, në konsultim të ngushtë edhe me organizatat e pakicave, ofroi kontributin e tij për hartimin e projektligjit “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” (tashmë i miratuar nga Parlamenti dhe në fuqi prej 2017) dhe 12 projektvendimeve në zbatim të ligjit, nga të cilat 9 akte nënligjore janë miratuar nga Këshilli Ministrave.⁴

Pas miratimit të ligjit kuadër, Komiteti për Pakicat Kombëtare i reformuar vijoi punën me emërimin e Kryetarit, Nënkyetarit, 9 anëtarëve të Komitetit si dhe stafit mbështetës.⁵ Rregullimi tanimë me ligj të veçantë i veprimtarisë së KPK-së e ka ridimensionuar këtë institucion si në përbërjen e tij ashtu edhe në mënyrën e përmbushjes së misionit për mbrojtjen e të drejtave dhe promovimin e kulturës dhe traditave të pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Krahas njohjes me ligj në mënyrë të shprehur të nëntë pakicave kombëtare dhe forcimit të pozitës ligjore të Komitetit, ligji krijon edhe një fond për financimin e projekteve të organizatave të pakicave, i cili administrohet nga KPK sipas kuadrit nënligjor të miratuar në 2021⁶.

Korniza ligjore e deritanishme parashikon detyrimin ligjor të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në fusha të tilla si mësimi dhe përdorimi i gjuhës, ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kulturor, si dhe pjesëmarrja në jetën publike të vendit. Komiteti ka nisur mbështetjen financiare të zbatimit të projekteve të vogla nga organizatat e shoqërisë civile të cilat përfaqësojnë interesat e pakicave. Për vitin 2022 Komiteti financoi festivalin e parë ndërkulturor të 9 pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Për vitin 2023 Komiteti shpalli fitues (5 projekte) në kuadër të thirrjes së hapur në muajin mars 2023, nën moton “E ardhmja është në origjinë”.

Anëtarët, përfaqësues të nëntë pakicave kombëtare, zhvillojnë periodikisht takime tematike dhe konsultative me organizatat e pakicave. Ata gjithashtu kanë marrë pjesë rregullisht në veprimtari të ndryshme, në vend dhe jashtë tij. KSHM (tashmë KPK) është përfaqësuar në disa konferenca për mbrojtjen e pakicave kombëtare, të tilla si lançimet e Planeve Kombëtare të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve për periudhat 2016-2020 dhe 2021-2025, dhe konferenca për zbatimin e Rekomandimeve të Seminarit IV dhe V, për Dialogun e Politikave Shqipëri-BE, 2019-2022.⁷

Pranë ambienteve të Komitetit, është përshtatur edhe një mjedis në formën e një galerie arti të titulluar ‘Parking Galeri’, pranë së cilës krijues dhe artistë që u përkasin pakicave kombëtare mund të ekspozojnë veprimtarinë e tyre.

⁴ VKM-të rregullojnë riorganizimin e Komitetit, përcaktojnë procedurat për zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve, kriteret e mbështetjes nga Fondi për Pakicat Kombëtare të projekt-propozimeve nga organizatat e pakicave, pajisjen me tekste shkollore, formimin e mësuesve dhe krijimin e klasave në gjuhën e pakicave; nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, dhe gjuhës së pakicave kombëtare, përgatitjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore për nxënës të pakicave kombëtare”; politika për pjesëmarrjen në jetën publike, krijimin e kushteve për të përdorur dhe zhvilluar elementet e identitetit dhe gjuhës së pakicave, kriteret për arsimimin në gjuhën e pakicave, etj. Lista e plotë e akteve nënligjore të hartuara me kontributin e Komitetit në zbatim të ligjit 96/2017 gjendet në seksionin e kornizës ligjore, në këtë dokument.

⁵ Struktura e re u miratua me urdhrin e Kryeministrit nr. 60, datë 01. 04. 2022.

⁶ VKM Nr. 769 datë 15.12.2021 “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e fondit për pakicat kombëtare”;

⁷ Lista e plotë e veprimtarive në aneksin nr. 1

KPK-ja është pjesë e grupit ndërinstitutional të punës, që udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë, për kapitullin e 23 “Liritë dhe të drejtat themelore”, të negociatave me BE-në. Që nga fillimi i procesit të negociatave me BE-në, KPK-ja ka dhënë kontributin e saj në këtë proces, sa herë i është kërkuar. Këto përpjekje i shërbejnë jo vetëm zbatimit të të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në përputhje me standardet dhe përvojat më të mira perëndimore, por njëkohësisht edhe përafrimit të legjislacionit të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Europian, duke kontribuar kështu edhe në rrugën drejt anëtarësimit.

1.1.2 Analiza e situatës

Analiza e situatës përfshin përmbledhjen e disa raporteve të rëndësishme dhe takimeve konsultative, duke ofruar njohuri të vlefshme për aspekte të ndryshme të punës së KPK-së. Këto burime përfshijnë raportin vjetor të vitit 2022 mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit, raportin vjetor të vitit 2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, raportin e Avokatit të Popullit 2021 për Agjencinë e të Drejtave Themelore të BE-së (FRA), raportin e 6-të të ECRI-t, raportin e 5-të të Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, progresin e BE-së (2022) për Shqipërinë, raportet e vlerësimit (për zbatimin e Fondit dhe nevojat institucionale të Komitetit) dhe fokus grupet dhe diskutimet me stafin dhe anëtarët e KPK-së në datat 16 shkurt 2023, 6 prill dhe 12 maj 2023. Për më tepër, konsultime janë mbajtur edhe me përfaqësues të shoqërisë civile të pakicave kombëtare në 5 qershor 2023, pranë zyrave të Komitetit.

Gjatë këtij procesi, grupi i punës, me ndihmën e dy prej ekspertëve të angazhuar nga Këshilli i Evropës identifikoi pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë, dhe kërcënimet. Mbi bazën e këtyre gjetjeve u formuluan vizioni, qëllimet, objektivat, dhe masat e Planit Strategjik për Zhvillimin Institucional të Komitetit, duke reflektuar misionin e tij përcaktuar sipas kornizës ligjore. Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur secili prej këtyre burimeve duke theksuar edhe dobishmërinë përkatëse.

Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit⁸ për vitin 2022 trajton një gamë të gjerë çështjesh të të drejtave të njeriut dhe vlerëson respektimin e këtyre të drejtave nga administrata publike.⁹ Vëmendje e veçantë i kushtohet grupeve të cënueshme, komuniteteve dhe individëve në rrezik, përfshirë personat që u përkasin pakicave kombëtare. Përgjatë vitit 2022, Avokati i Popullit ka trajtuar 9 raste me iniciativën e vet dhe 4 ankesa individuale lidhur me pakicat kombëtare. Avokati i Popullit thekson se shumë ankesa të marra nga individë që i përkasin pakicave kombëtare nuk lidhen me të drejtat që burojnë nga statusi i tyre si anëtar i një pakice, por më shumë me çështje si strehimi, punësimi, qasje në kujdesin social dhe kushtet e përgjithshme të jetesës.

⁸ Zyra e Avokatit të Popullit, si institucioni më i lartë në vend i mandatuar nga Kushtetuta, vepron në mënyrë të pavarur nga qeveria. Roli kryesor i tij është të mbrojtë dhe promovojë të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e pakicave kombëtare. Avokati i Popullit vepron si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve dhe lehtëson komunikimin midis individëve dhe administratës publike. Transparenca dhe bashkëpunimi me vendim-marrësit janë aspekte kyçe të veprimtarisë së tij. Avokati i Popullit paraqet raporte në Kuvend, i cili i vlerëson dhe i miraton duke dhënë edhe rekomandime të caktuara. Rekomandimet e Kuvendit për Avokatin e Popullit për vitin 2021 theksuan nevojën për tu fokusuar veçanërisht në disa fusha të tilla si informimi i nxënësve për të drejtat e tyre dhe promovimi i mekanizmave mbrojtës për qytetarët më të cënueshëm dhe të marginalizuar. Për më shumë, shihni raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2022 në:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtarise%20s%20institucionit%20te%20Avokatit%20te%20Popullit%20per%20vitin%202022.pdf>.

⁹ Raportet Vjetore të Avokatit të Popullit për periudhën 2000 – 2022 gjenden në:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/>

Avokati i Popullit ka përqendruar vëmendjen te komunitetet rome dhe egjiptiane, për shkak të sfidave të veçanta që ata hasin, veçanërisht në qasjen e shërbimeve të mbrojtjes sociale, arsimit gjithëpërfshirës dhe legalizimin e banesave. Raporti thekson fenomenin shqetësues të antixhipsizmit (diskriminimi racial kundër romëve dhe egjiptianëve), i cili përfshin veprime individuale, politika institucionale dhe praktika që marginalizojnë dhe cenojnë të drejtat, kulturën dhe stilin e jetës së romëve dhe egjiptianëve. Gjuha e urrejtjes ndaj individëve rom dhe grupeve të tjera si egjiptianët përkeqësojnë stereotipat negative dhe kontribuojnë në një formë specifike të diskriminimit racial. Avokati i Popullit ka rekomanduar zhvillimin e planeve të integritetit dhe përfshirjes në nivelin e qeverisjes lokale për komunitetet rome dhe egjiptiane. Gjithashtu, AP u bën thirrje Kryeministrit dhe Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për përfundimin e miratimit të akteve nënligjore në përputhje me ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Avokati i Popullit vë në dukje se njohja dhe respektimi i të drejtave të pakicave nuk është një privilegj i dhënë nga shteti, por një detyrim natyror që buron nga dinjiteti dhe diversiteti njerëzor, i cili përbën një investim për të ardhmen e shoqërisë.¹⁰

Ky këndvështrim sugjeron se, krahas të drejtave të garantuara personave që u përkasin pakicave kombëtare, kujdes i veçantë duhet treguar ndaj pengesave specifike që këta qytetarë hasin për të përfituar shërbimet sociale dhe publike. Prandaj, përpjekjet bashkëpunuese midis KPK-së dhe Avokatit të Popullit janë të rëndësishme për t'iu përgjigjur efektivisht sfidave të veçanta me të cilat përballen pakicat.

Raporti vjetor për vitin 2022¹¹ i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim (KMD)¹² përshkruan veprimtarinë dhe vendimet e marra nga KMD për adresimin e rasteve të diskriminimit në fusha të ndryshme, duke përfshirë shërbimet, punësimin dhe arsimin. Raporti gjithashtu thekson shkaqet specifike të diskriminimit si raca, gjendja ekonomike apo anëtarësimi në grupe të veçanta. KMD-ja ka marrë disa vendime dhe u ka dhënë rekomandime institucioneve përkatëse për të rregulluar këto situata, si dhe ka vendosur sanksione e gjoba.

Konkretisht gjatë vitit 2022, në fushën e shërbimeve publike, janë nxjerrë 98 vendime, 3 rekomandime dhe janë vendosur 2 gjoba. Në fushën e punësimit, KMD ka marrë 107 vendime, duke gjetur diskriminim në 39 raste. Në sektorin e arsimit, janë trajtuar 9 raste, nga të cilat në 4 raste është vërtetuar diskriminimi. Në mënyrë të veçantë, Komisioneri ka trajtuar 22 raste ankesash lidhur me diskriminim racial, të cilat rezultuan në 4 vendime për diskriminim dhe vendosjen e gjobave për mosrespektimin e vendimeve të diskriminimit. Raporti identifikon raste që përfshijnë shkaqe të shumëfishta për diskriminim dhe forma të rënda të diskriminimit, veçanërisht në çështje lidhur me aksesueshmërinë, punësimin dhe ofrimin e shërbimeve publike e sociale. Shumica e ankesave drejtohen kundër institucioneve qendrore dhe lokale

¹⁰ Avokati i Popullit, Raporti Vjetor 2022, faqet 8 – 131.

¹¹ Raportet vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për periudhën 2010-2022 gjenden në: <https://www.kmd.al/raporte-vjetore/>.

¹² Sipas Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtje efektive kundër diskriminimit dhe sjelljeve që e inkurajojnë atë. Raporti vjetor i Komisionerit përmban vlerësime dhe rekomandime, duke përfshirë kornizën ligjore, shqyrtimin e ankesave dhe vendimet lidhur me forma të ndryshme të diskriminimit. Raporti përfshin informacion mbi rezultatet e rasteve, procedurat ligjore dhe veprimtaritë e zyrave rajonale të tij. KMD ndihmon viktimat në bërjen e ankesave, zhvillon hetime, vendos gjoba administrative dhe mund të nisë procedura ligjore. Ai gjithashtu zhvillon sondazhe të pavarura, publikon raporte, propozon ndryshime ligjore dhe angazhohet me publikun dhe grupet sociale relevante për të adresuar diskriminimin. KMD kontribuon në raportimin ndërkombëtar, promovon ndërgjegjësimin publik dhe bashkëpunon me mediat për të luftuar diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes. Për më shumë detaje, shihni raportin vjetor 2022 të KMD në: https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/03/Raporti-KMD-2022_compressed.pdf.

të administratës publike. Në raport paraqiten shembuj të problematikave të trajtuara, duke përfshirë regjistrimin e fëmijëve rom dhe egjiptianë, gjuhën diskriminuese në media, refuzimin e shërbimeve nga autoritetet lokale dhe vonesa në legalizimin e banesave. Vendimet e marra nga Komisioneri kanë synuar promovimin e barazisë, parandalimin e praktikave diskriminuese dhe adresimin e rasteve të diskriminimit në fusha dhe për shkaqe të ndryshme. Krahas këtyre, veprimtaritë e Komisionerit kanë përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit publik, ndërveprimin me grupet e ndryshme shoqërore, dhe bashkëpunimin me mediat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse.¹³

Mandati i KMD-së përqendrohet veçanërisht tek antidiskriminimi, i cili është thelbësor për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të grupeve të pakicave kombëtare. Krahas njohjes me vendimet dhe argumentimin e ofruar nga KMD në rastet që kanë të bëjnë me pakicat, Komiteti për Pakicat Kombëtare duhet të bashkërendojë punën e tij programatike me të dy institucionet të cilat mbrojnë barazinë e qytetarëve, KMD-ja dhe Avokati i Popullit.

Raporti i Avokatit të Popullit i vitit 2021 drejtuar Agjencisë së të Drejtave Themelore (FRA) të Bashkimit European, ofron një pasqyrë të zhvillimeve ligjore dhe politikave, në tetë fusha themelore. Këto fusha përfshijnë: (1) barazinë dhe mos-diskriminimin; (2) racizmin, ksenofobinë, dhe intolerancën; (3) përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve; (4) azili dhe emigracioni; (5) informacioni, privatësia, dhe mbrojtja e të dhënave; (6) të drejtat e fëmijëve; (7) aksesin në drejtësi; (8) të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Pas një përshkrimi të detajuar për secilin nga këto fusha, raporti identifikon edhe praktika premtuese, ku, ndër të tjera, vlen të përmendet, zhvillimi i Kodit të sjelljes së partive politike, zbatimi i Programit 'ROMACTED', sistemi i raportimit online kundër abuzimit të fëmijëve.¹⁴

Ky raport, përbën një bazë të mirë për të identifikuar fushat përparësore të mbrojtjes së të drejtave të personave që u përkasin edhe pakicave kombëtare. Ai gjithashtu vendos theksin tek reforma ligjore e ndërmarrë në këtë drejtim kohët e fundit.

Raporti i gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë (2020) paraqet gjendjen deri në 11 dhjetor 2019. Ai përmban gjetje dhe rekomandime lidhur me (I) barazinë efektive dhe aksesin në të drejtat, duke u përqendruar tek organet e barazisë, arsimi gjithëpërfshirës, emigrantët e parregullt, dhe personat LGBTI; (II) gjuha e urrejtjes dhe dhuna e motivuar nga urrejtja; (III) integrimi dhe përfshirja e romëve dhe egjiptianëve, por edhe e emigrantëve dhe refugjatëve. Raporti paraqet 14 rekomandime (faqet 31-32), të cilat në mënyrë të përmbledhur përfshijnë rritjen e efikasitetit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parandalimin dhe luftimin e racizmit dhe intolerancës dhe bullizmit në shkolla, zbatimin e planit të veprimit për personat LGBTI, krijimin e një sistemi për monitorimin e incidenteve të gjuhës së urrejtjes, dialogun midis autoriteteve ligjzbatuese dhe shoqërisë civile, rritjen e kapaciteteve të organeve vendore dhe rajonale dhe zbatimin e masave të planit të integritetit për romët dhe egjiptianët.¹⁵

Këto rekomandime shërbejnë si një udhërrëfyes i dobishëm për veprimtarinë e Komitetit në luftën kundër intolerancës dhe promovimit të koordinimit me institucionet e tjera përgjegjëse përfshirë AP dhe KMD, për të adresuar çështjet e diskriminimit.

Raporti i pestë i Shqipërisë (maj 2021) për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, sipas Nenit 25, paragrafi 2 i Konventës. Raporti trajton masat e ndryshme për zbatimin e

¹³ Raporti vjetor i KMD për 2022, faqet 41-50.

¹⁴ Albania, The Ombudsperson (Avokati i Popullit (2021), 'Reply to the request for information of the Ombudsman in the framework of the FRA human rights report', 27 September 2021.

¹⁵ Raporti i Gjashtë i ECRI-t 2020.

Konventës dhe dialogun me Komitetin Këshillues të Konventës Kuadër. Në mënyrë specifike, raporti adreson çështjet e identifikuar në ciklin e katërt të monitorimit në fushat përkatëse sipas neneve të Konventës. Këto fusha përfshijnë: (1) ndalimin e diskriminimit; (2) kulturën; (3) tolerancën dhe dialogun ndërkulturor; (4) të drejtën për të manifestuar besimin fetar; (5) aksesin në media; (6) përdorimin e gjuhës në marrëdhëniet me autoritetet; (7) emrat, shenjat dhe treguesit topografikë; (8) arsimin; (9) hapjen e institucioneve private; (10) të drejtën për të mësuar dhe t'u mësuar në gjuhën e pakicave; (11) pjesëmarrjen në jetën publike; (12) përbërjen e popullsisë; (13) bashkëpunimin dypalësh dhe ndërkombëtar; si dhe (13) zbatimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në nivel vendor.¹⁶

Duke qenë se ky raport adreson në mënyrë të veçantë situatën e pakicave kombëtare përbën një burim të dobishëm për Komitetin, duke treguar fushat e ekspertizës të cilat duhet të zhvillojë Komiteti për dhënien e kontributit profesional në përmbushje të misionit të tij.¹⁷

Progres Raporti i BE-së për Shqipëri i vitit 2022, thekson se Shqipëria përgjithësisht vepron në përputhje me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Shqipëria ka plotësuar legjislacionin e nevojshëm dhe politikat zbatuese në fushën e drejtësisë për të mitur, mbrojtjen nga diskriminimi të komunitetit (LGBTIQ), barazinë gjinore, përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane, dhe mbrojtjes së pakicave kombëtare. Në mënyrë të veçantë, raporti njeh përpjekjet për miratimin e pjesës më të madhe të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare, përfshirë edhe krijimin e një fondi për projektet e shoqërisë civile në mbështetje të të drejtave të pakicave. Megjithatë, është ende një pjesë e mbetur e akteve nënligjore të pamiratuara. Këto përfshijnë projektaktet që rregullojnë (a) lirinë për t'u vetidentifikuar si anëtar i një pakice kombëtare, dhe (b) përdorimin e gjuhëve të pakicave. Raporti rekomandon miratimin e këtyre projekakteve dhe thekson gjithashtu nevojën për (c) rritjen e kapaciteteve institucionale të Komitetit për Pakicat Kombëtare. Për më tepër, raporti thekson rëndësinë e marrjes së masave nga Shqipëria për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parandalimin e përsëritjes së shkeljeve masive të të dhënave personale. Ai sugjeron përshpejtimin e përpjekjeve për të harmonizuar legjislacionin e vendit me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).¹⁸ Rekomandimet e përfshira në këtë raport orientojnë më tej veprimtarinë e Komitetit në përmbushjen e këtyre detyrimeve, duke kontribuar kështu në zbatimin e standardeve evropiane në fushën e të drejtave të pakicave kombëtare.

Departamenti i Analizës së Projekteve në Komitetin e Pakicave Kombëtare ka hartuar një **Raport për Vlerësimin e Nevojave të Pakicave Kombëtare** në dhjetor 2022. Ky raport synon të orientojë fushat e ndërhyrjeve për projektet nga OSHC-të që mbështeten nga Fondi për Pakicat Kombëtare, mbi bazën e VKM nr. 769/2021.¹⁹ Raporti identifikon nevojat dhe kërkesat e secilës pakicë kombëtare përmes dialogut me organizatat që përfaqësojnë interesat e pakicave përkatëse dhe i kategorizon ato në tetë fusha specifike. Këto fusha përparësore, të cilat mund të mbështeten nga Fondi për Pakicat Kombëtare, janë si vijon: (1) kurse të gjuhës së pakicave; (2) organizimi/pjesëmarrja në festivale folklorike; (3) shkëmbime ndërkulturore me komunitete të cilat ruajnë karakteristika të njëjta dalluese në shtete të tjera; (4) përkthime dhe botime literature (mbi pakicat dhe në gjuhën e pakicave); (5) promovimi i figurave të spikatura nga radhët e personave që u përkasin pakicave kombëtare; (6) mbështetja e veprimtarive

¹⁶ Raport i Pestë Periodik i Shqipërisë mbi zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare” (5 maj 2021).

¹⁷ Ndonëse ky është një dokument i Qeverisë së Shqipërisë ai është reflektiv ndaj Opinionit të Katërt (2017) të Komitetit Këshillues mbi Zbatimin e Konventës Kuadër. Opini i Pestë i Komitetit Këshillues pritet të publikohet në fund të vitit 2023.

¹⁸ Progres raporti i BE-së për Shqipërinë (nëntor 2022), faqe 5, 26.

¹⁹ *Raport Vlerësimi Nevojash*, Komiteti i Pakicave Kombëtare (dhjetor 2022).

artizanale; (7) ngritja dhe ruajtja e seksioneve institucionale që dokumentojnë dhe promovojnë kostumografinë dhe veshjeve tradicionale të pakicave; (8) mbështetja e veprimtarive të qendrave ndërkulturore në nivel vendor.²⁰ Krahas identifikimit të fushave përparësore të pakicave, ky raport shërben si një pikënisje e vlefshme për vlerësimin e vazhdueshëm të impaktit të projekteve të financuara përmes Fondit.

Këshilli i Evropës përmes një eksperteje ndërkombëtare kontribuoi në përgatitjen e një **Raport Vlerësimi Nevojash për zhvillimin institucional të Komitetit të Pakicave Kombëtare**. Ky raport propozon një udhërrëfyes me hapat e domosdoshme për funksionimin me efektivitet të KPK-së. Raporti sugjeron masa të tilla si: (1) zhvillimin e rregullores së brendshme; (2) vënien në dispozicion të ambienteve dhe mjeteve bazike të punës stafit dhe anëtarëve përfaqësues; (3) hartimin, ndër të tjera, të programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të vet institucionit; (4) zhvillimin e një strategjie komunikimi; (5) hartimin e një udhërrëfyesi/fjalorthi mbi terminologjinë që ofron shpjegimin e termave të nevojshëm; dhe (6) krijimin e një liste me ekspertë (apo dhe persona burimorë) në fushën e pakicave kombëtare, të cilët mund të ofrojnë ekspertizë dhe asistencë në dhënien e opinioneve, rekomandimeve dhe propozimeve bazuar mbi kërkimin shkencor.²¹

Krahas këtyre raporteve, komentet nga punonjës të **Këshillit të Evropës në Strasburg**, Francë ofrojnë njohuri të mëtejshme. Këto komente sugjerojnë marrjen në konsideratë të disa masave, të tilla si: (1) vënien e theksit mbi pozicionin që KPK ka në organigramën e qeverisë, duke nënkuptuar shtimin e togfjalëshit 'pranë Kryeministrit' në përmendjen e titullit të institucionit; (2) vlerësimin e mundësisë që Kryetari dhe Nënkryetari i Komitetit të zgjidhen nga vetë 9 anëtarët përfaqësues të pakicave; (3) sigurimin e administrimit efektiv të aplikimeve për grante dhe dhënies përparësi të qasjeve institucionale ndaj çështjeve të pakicave; (4) sigurimin e alokimeve buxhetore disa-vjetore për muzetë, qendrat komunitare, bibliotekat, shtypin e shkruar, radiofonik e televiziv të pakicave; dhe (5) bashkërendimin e projekteve që financohen nga Fondi i KPK-së me ato të Strategjisë që adresojnë problematikat e pakicave romë dhe egjiptiane, me qëllim shmangien e çdo mbivendosjeje të mundshme.²²

Këto burime të larmishme së bashku kanë shërbyer si një bazë e mirë për të orientuar diskutimin e grupit të punës mbi zhvillimin e analizës SWOT, formulimin e rekomandimeve dhe zhvillimin e Plan-Vepërimit Strategjik për 2023-2026.

²⁰ Ibid.

²¹ Needs Assessment Report for Committee for National Minority, drafted by Elisabeth Sandor -Szalay, expert hired by the Council of Europe (June 2022).

²² Komentet mbi Raportin e Vlerësimit të Nevojave Institucionale dhënë përmes postës elektronike nga staf i Këshillit të Evropës në Strasburg.

Analiza SWOT ²³	
Pikat e Forta	Pikat e Dobëta
-Komiteti ka një pozicion të spikatur si një <i>institucion këshillimor pranë Kryeministrit, gjë e cila</i> i jep autoritet të konsiderueshëm në raport me institucionet e tjera publike; - Disa prej anëtarëve/stafit zotërojnë përvoja dhe kualifikime të vlefshme në fushën e mbrojtjes së pakicave dhe/ose në organet qendrore të administratës publike; -Raportet ekzistuese të vlerësimit të nevojave të pakicave kombëtare dhe nevojave institucionale të vetë Komitetit përbëjnë një bazë të mirë për bashkërendimin e punës në të dy drejtimet; - Ekziston një frymë e brendshme bashkëpunimi midis anëtarëve dhe stafit administrativ që ushqen gjithëpërfshirjen, tolerancën kulturore dhe respektin e ndërsjellë; -Komiteti zbaton një qasje me fushëveprim të gjerë duke bashkëpunuar me institucionet e tjera dhe nxitur komunikimin ndërinstitucional. - Komiteti ruan marrëdhënie shumë të mira me organizatat e shoqërisë civile; - Pavarësisht pengesave, Komiteti ka shënuar arritje në përmbushjen me sukses të misionit të tij; - Vitet e fundit, Komiteti ka zgjeruar stafin dhe përmirësuar imazhin dhe rolin e tij.	- Burimet e pamjaftueshme financiare: buxheti i Komitetit nuk mbulon kosto operacionale dhe shpenzime lidhur me përmbushjen e detyrave të tij funksionale; -Mungesa e një pakete trajnimi/orientimi për anëtarët përfaqësues dhe stafin administrativ mbi zbatimin e duhur të kornizës normative, praktikave të punës, dhe metodologjinë e komunikimit që zbaton Komiteti për Pakicat Kombëtare; - Veprimtaria e KPK-së ka vizibilitet të ulët, përfshirë nevojën për të përmirësuar webfaqen e KPK-së me informacion relevant dhe të dobishëm për përdoruesit; -Sfida për t'u fokusuar njëkohësisht në forcimin institucional të vetë Komitetit dhe në adresimin e duhur të problematikave të pakicave; - Mungesa e mjediseve infrastrukturore (zyrave) dhe mjeteve të përshtatshme të punës (përfshirë mungesë automjeti) që nga marsi 2004; - Mungesa e specialistëve për IT dhe PR për të menaxhuar efektivisht teknologjinë e informacionit dhe marrëdhënien me publikun; - Kapacitete të pamjaftueshme për shkrim projektsh, ngritje fondesh, dhe vlerësim; -Mungesa e një qasjeje të vazhdueshme kërkimore/të bazuar në evidenca për të adresuar çështje të ndryshme lidhur me të drejtat dhe interesat e pakicave, të tilla si <i>vetidentifikimi</i> (gjatë realizimit të një të drejtë të caktuar apo gjatë censit për efekt të mbledhjes së statistikave mbi pakicat), <i>terminologjinë e përshtatshme, format e pjesëmarrjes</i> së pakicave, <i>njohja</i> e pakicave të reja, <i>mbrojtjen e të drejtave</i> të personave që u përkasin pakicave, respektimin e ndërsjellë dhe promovimin e bashkëjetesës paqësore dhe mësimet nga <i>praktikat më të mira</i> europiane;
Mundësitë	Faktorët kërcënues
- Angazhimet ndërkombëtare të vendit tonë dhe procesi i anëtarësimit në BE, bashkë me përafrimin e kuadrit ligjor, paraqesin mundësi të shtuara; - Qeveria/Kuvendi aktual ka shprehur vullnet politik për të përmirësuar kuadrin ligjor, veçanërisht përmes miratimit të ligjit të ri dhe njohjes së shprehur të 9-të pakicave kombëtare;	- Mungesë ndërgjegjësimi tek institucionet publike mbi rolin dhe përgjegjësitë e KPK; -Kuptueshmëria e ulët dhe shpesh keqinterpretimi (nga institucionet publike, organizatat e pakicave, dhe publikut) i rolit të Komitetit, të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, dhe pozitës së pakicave kombëtare në raport me popullsinë shumicë dhe vetë Republikën e Shqipërisë;

²³ Feedback-u për Analizën SWOT i marrë gjatë workshopit nr. 1 me grupin e punës të zhvilluar në dt. 16 shkurt 2023, dhe rishikuar gjatë workshopit nr. 2 në dt. 6 prill 2023 zhvilluar në zyrat e KPK.

-Plani strategjik mund të bazohet në përvojën e deritanishme të bashkëpunimit dhe ndërveprimit që ekziston midis anëtarëve përfaqësues dhe stafit të komitetit; - Hartimi i Planit Strategjik përbën një mundësi për të raportuar progres drejt përbushjes së kërkesave të BE-së në kuadrin e negociatave për anëtarësim; -Ekzistenca e Projektit të KIE si dhe aktorëve të tjerë si OSCE, BE, agjencitë e UN, ambasadat dhe agjencitë zhvillimore të vendeve të ndryshme etj., përbën një mundësi për mbështetje institucionale me ekspertizë dhe/ose financim në kryerjen e veprimtarive të Komitetit; -Programet qeveritare të vendeve mike të cilat ndajnë karakteristika dalluese të përbashkëta me pakica të caktuara mund të ofrojnë mbështetje të vlefshme; - Programe bashkëpunimi me organizata që mbrojnë të drejtat e interesat e pakicave të caktuara janë të mundshme; - Pjesëmarrja në vizita studimore, shkëmbime praktikash premtuese dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga organizata/institucione homologe apo partnere janë të mundshme; -Shkëmbimi i praktikave të mira me homologët e tjerë mund të përmirësojë punën e Komitetit; -Aktorë të ndryshëm kanë treguar interes për pjesëmarrje apo përfshirje në veprimtarinë e KPK-së, siç janë p.sh. universitetet, të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e tezave për studime master e doktoraturë në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave, pa asnjë kosto. -Komiteti gëzon interesin dhe mbështetjen e përfaqësuesve të pakicave kombëtare. -Komiteti gëzon interesin dhe mbështetjen nga organizatat ndërkombëtare dhe partnerët kyç (përfshirë Këshillin e Europës, OSBE-në, BE-në, OKB-në dhe të tjerë). -Shoqëria shqiptare karakterizohet nga një klimë shoqërore ku mikpritja dhe pranimi i diversitetit kulturor konsiderohen si veçori dalluese të saj	- Ndërsa ligji dhe pjesa më e madhe e miratuar e akteve nënligjore kanë nevojë të vihen në zbatim përmes praktikave të punës në institucionet përgjegjëse, mbeten ende pa miratuar disa akte nënligjore, të cilat kërkojnë ekspertizë shtesë ligjore nga Komiteti për të dhënë kontributin e tij profesional; - Mbizotërojnë qëndrime të tejskajshme dhe/ose përjashtuese apo komunikim përmes gjuhës së urrejtjes, kryesisht në rrjetet sociale. Raste sporadike të këtyre qëndrimeve (kryesisht të pavetëdijshme) vihen re edhe mes punonjësve të administratës publike; - Marrëdhëniet e brishta dhe të paqëndrueshme mes vendeve të rajonit, mund të ndikojnë edhe në marrëdhëniet mes pakicave kombëtare të caktuara dhe popullsisë shumicë; -Të dhënat e censit të shkuar mbi popullsinë e pakicave kombëtare të caktuara janë kundërshtuar nga organizatat e pakicave përkatëse si jorealiste.²⁴ Kjo ka çuar në mospërfilljen/përjashtimin e problematikave të këtyre pakicave kombëtare në shkallë vendi dhe zona të caktuara.; - Disa institucione nuk kanë treguar vullnet për bashkëpunim apo për të konsideruar problemet me të cilat përballen pakicat kombëtare; - Zonat/komunitetet e pakicave kombëtare marrin investime të pamjaftueshme; - Organizatat e pakicave kombëtare të veçanta kanë kapacitete institucionale të pamjaftueshme për hartim dhe zbatim të suksesshëm projektesh; - Ka mungesë burimesh financiare për të bashkëpunuar dhe angazhuar ekspertë dhe persona burimorë në fushën apo që u përkasin pakicave kombëtare; -Procedurat e zgjatura në emërimin e anëtarëve për shkak të procedurave / praktikave të rekrutimit pengojnë në vijueshmërinë e veprimtarisë së Komitetit.
--	---

Përfundime dhe rekomandime

Nga analiza e mësipërme si dhe nga konstatimet që rezultojnë nga analiza SWOT, mund të konkludohet se problematikat kryesore lidhen me pesë fusha, secila shoqëruar me sfida me ndikim shoqëror të cilat

²⁴ Disa nga arsyet e pretenduara për këtë kundërshtim janë: formulimi i papërshtatshëm i pyetjeve mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, udhëzimi i pamjaftueshëm i anketuesve, hezitimi për t'u deklaruar zyrtarisht nga frika e paragjytimeve, mospërfshirja e anketuesve nga radhët e pakicave kombëtare, konsultimi i pamjaftueshëm me organizatat që përfaqësojnë interesat e pakicave kombëtare.

duhen adresuar. Këto fusha së bashku orientojnë përcaktimin e qëllimeve strategjike të planit strategjik për zhvillim institucional të Komitetit, i cili vepron nën juridiksionin e Kryeministrit. Në këtë institucion, përfaqësues të nëntë pakicave kombëtare të njohura me ligj punojnë së bashku me stafin teknik për të dhënë këshilla lidhur me zgjidhjet ligjore dhe politikat për çështjet e pakicave kombëtare në vend.

Së pari, **kapacitetet institucionale dhe organizative** të Komitetit janë ende në rritje për të mundësuar kryerjen më me efektivitet të veprimtarisë si nga ana e anëtarëve ashtu edhe e stafit të Komitetit. Sfidat me ndikim shoqëror të lidhura me kapacitetet institucionale dhe organizative janë:

- **Efektiviteti:** Komiteti hasë vështirësi në adresimin efektiv të nevojave dhe shqetësimeve të pakicave kombëtare për shkak të logjistikës të kufizuar.
- **Ndikimi:** Kapacitetet institucionale dhe organizative kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në veprimtarin e tij.

Së dyti, pamjaftueshmëria e burimeve financiare për mbulimin e **kostove operacionale dhe zhvillimin e veprimtarive tematike** të Komitetit sjell pengesa thelbësore në funksionimin e Komitetit dhe përmbushjen e mandatit të tij. Kjo paraqet sfidat e mëposhtme:

- **Zbatimi i Programit:** Komiteti hasë pengesa në zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të tij, përfshirë iniciativat që synojnë të promovojnë të drejtat dhe mirëqenien e pakicave kombëtare.
- **Komunikimi:** Mungesa e burimeve financiare ndikon aftësinë e Komitetit për të komunikuar me pakicat kombëtare, zhvilluar fushata të ndërgjegjësimit, etj.

Së treti, **korniza ligjore, politikat, dhe praktikat e punës mbi pakicat kombëtare** janë drejt plotësimit dhe kërkojnë shpjegime në vazhdimësi për të shmangur interpretime të gabuara nga vetë institucionet përgjegjëse. Sfidat e lidhura me kornizat ligjore, të politikave, apo të praktikave të punës mbi pakicat kombëtare përfshijnë:

- **Interpretimet:** Mungesa e shpjegimeve të qarta dhe udhëzimeve ligjore të hollësishme sjell kuptime dhe interpretime të gabuara të drejtave dhe mbrojtjes që u njihen pakicave kombëtare.
- **Përgjegjshmëria:** Kornizat rregullatore ende të pamiratuara pengojnë përmbushjen e të drejtave të pakicave kombëtare, dhe përparimin drejt një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe me barazi.

Së katërti, **bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitutional** me institucione të tjera bashkëpërgjegjëse ndikon në raportimin dhe monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave për pakicat kombëtare. Sfidat që burojnë nga bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve përfshijnë:

- **Monitorimi:** Bashkëpunimi efektiv mes institucioneve përgjegjëse ndikon në raportimin dhe monitorimin e plotë të zbatimit të kornizës ligjore dhe politikave mbi pakicat kombëtare. Koordinimi ndikon drejtëpërdrejtë në kuptueshmërinë e duhur të gjendjes reale të të drejtave të pakicave.
- **Mbivendosjet:** Pa koordinimin e duhur, institucionet e ndryshme mund të angazhohen në veprimtari të cilat mbivendosen ose rezultojnë në punë të dyfishta, duke shkaktuar humbje të burimeve dhe një qasje të fragmentuar ndaj sfidave me të cilat përballen pakicat kombëtare.

Së pesti, **informimi dhe ndërgjegjësimi** së bashku me dialogun **institucional** me përfaqësuesit e pakicave kombëtare (përfshirë, por pa u kufizuar tek OSHC-të, personalitete të shquara), ndikon në kuptueshmërinë dhe pritshmëritë, qoftë mbi rolin e Komitetit, ashtu edhe mbi mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare. Sfidat shoqërore të lidhura me ndërgjegjësimin, përdorimin e mjeteve të informacionit, si dhe dialogun institucional, janë:

• *Kuptueshmëria*: Mjetet e ndërgjegjësimit dhe shpërndarja efektive e informacionit kontribuon në kuptimin e rolit të Komitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare, si nga vetë popullsia e pakicave kombëtare, ashtu edhe nga publiku i gjerë.

• *Gjithëpërfshirja*: Dialogu institucional me përfaqësuesit e pakicave kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, apo personaliteteve të spikatura të pakicave ndikon në kontribute të dobishme nga perspektiva të ndryshme. Gjithëpërfshirja rrit aftësinë e Komitetit për të formuluar politika dhe programe gjithëpërfshirëse që me të vërtet adresojnë nevojat e pakicave kombëtare.

Për të adresuar këto sfida me ndikim të drejtëpërdrejtë shoqëror, nevojiten përpjekje të përbashkëta për të forcuar kapacitetet institucionale të Komitetit, alokuar burime financiare të mjaftueshme, përmirësuar kornizën ligjore, nxitur bashkëpunim ndërinstitutional dhe rritur komunikimin dhe nismat ndërgjegjëse. Sigurimi i diversitetit dhe balancës gjinore në përbërjen e KPK-së mbeten aspekte të rëndësishme për t'.

Duke marrë në konsideratë pesë fushat kryesore të problematikave dhe analizën e detajuar SWOT mbi pikat e forta, pikat e dobëta, mundësi, dhe faktorëve kërcënues, të cilët kanë një ndikim themelor në përmbushjen e përgjegjësi të Komitetit, janë identifikuar rekomandimet e mëposhtme.

- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve të brendshme dhe të jashtme të Komitetit. Pajisja e të gjithë anëtarëve/stafit me njohuri të përshtatshme (përmes një 'pakete trajnimit orientues' dhe 'programi trajnimit të vazhdueshëm') mbi mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, duke përfshirë, ndër të tjera, kornizën normative, praktikën e punës dhe metodologjinë e komunikimit në përputhje me misionin dhe vizionin e Komitetit.
- Vënia e theksit tek pozita autoritare e këtij institucioni në organikën e Këshillit të Ministrave, duke iu referuar atij, në formën 'Komiteti për Pakicat Kombëtare në varësi të Kryeministrit'.
- Ngritja e mekanizmave dhe strukturave të duhura për bashkëpunimin ndërinstitutional dhe koordinimin me institucionet e tjera përgjegjëse, përfshirë autoritetet vendore duke qenë se shumë prej të drejtave garantohen në nivel vendor. Kjo ndihmon në sigurimin e monitorimit dhe raportimit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe në zbatimin e plotë të politikave dhe kornizës ligjore. Bashkërendimi i punës midis KPK dhe institucioneve homologe dhe bashkëpërgjegjëse në nivelin *programatik* për mbrojtjen e pakicave nga diskriminimi. Eksplorimi i mundësive për t'u koordinuar edhe në nivelin *logjistik* për shfrytëzimin e koordinuar të infrastrukturës materiale dhe organizative.
- Identifikimi i një *grupi ekspertësh dhe personash burimorë*. Komiteti (me ndihmën edhe të organizatave/institucioneve partnere) mund të këshillohet apo asistohet sipas nevojës për interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit ligjor e nënligjor mbi pakicat përgjatë zbatimit të planit strategjik. Roli dhe angazhimi i këtij grupi ekspertësh dhe personash burimorë vlerësohet në planet vijuese.
- Sigurimi i financimeve shtesë dhe mbështetjes institucionale përmes aplikimit për grante projektsh apo marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata partnere që ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose institucionale. Kjo do të mundësojë qëndrueshmërinë e veprimtarive të Komitetit.
- Reflektimi i plotë dhe në mënyrë të qartë i rolit dhe përgjegjësi të anëtarëve dhe stafit në Rregulloren e Brendshme.

- Dokumentimi i përvitshëm i veprimtarisë së Komitetit në raporte vjetore dhe publikimi i tyre në webfaqen e Komitetit në gjuhën shqipe (sipas mundësisë edhe në anglisht, dhe gjuhët e pakicave kombëtare).
- Bashkëpunimi me institucionet relevante për të sqaruar kornizën ligjore, politikat dhe praktikën në lidhje me pakicat kombëtare. Kjo përfshin hartimin e udhëzimeve të qarta për të ndihmuar institucionet në kuptimin dhe zbatimin e saktë të instrumenteve për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare. Përgatitja e një udhërrëfyesi mbi rolin e Komitetit si dhe të drejtat dhe interesat e pakicave kombëtare në Shqipëri, duhet të reflektojë jo vetëm kuadrin ligjor dhe institucional, por edhe praktikën më të mira mbi pakicat kombëtare.
- Përdorimi në mënyrë aktive i mjeteve të ndryshme, si fushatat informative, takimeve publike dhe dialogun institucional, për të rritur ndërgjegjësimin e popullsisë së pakicave dhe publikun e gjerë, në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Edhe pse Plani Strategjik kryesisht thekson bashkëpunimin me pakicat kombëtare, është shumë e rëndësishme që popullsia e shumicës të jetë e ndërgjegjësuar dhe t'i japë përparësi këtyre çështjeve. Prandaj, është thelbësor informimi dhe ndërgjegjësimi i popullsisë së shumicës dhe pakicave kombëtare mbi rolin e Komitetit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare.

1.2 Plani Strategjik 2023 – 2026

1.2.1 Synimi

Dokumenti synon të përcaktojë vizionin, qëllimet, objektivat dhe masat specifike për zhvillimin institucional të Komitetit për Pakicat Kombëtare, si një institucion qeveritar i përkushtuar për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitutional dhe për të kontribuar në zbatimin dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, në përputhje me kuadrin normativ përkatës.

1.2.2 Skema e qëllimeve strategjike

Skema e qëllimeve strategjike kategorizon përfundimet dhe rekomandimet në pesë fusha kryesore, të cilat përpunohen më tej në seksionin II Planifikim Strategjik. Këto kategori reflektojnë kuadrin ligjor, misionin dhe vizionin e KPK-së.

1. **Fuqizimi institucional dhe kapaciteteve organizative** për të rritur efektivitetin dhe eficiencën e KPK-së.
2. **Mbështetja dhe ndërmarrja e veprimtarive që synojnë përmbushjen e të drejtave** të personave që u përkasin pakicave kombëtare përmes Fondit, aplikimit për grante, dhe bashkëpunimit institucional me organizata donatore/partnere.
3. **Dhënia e kontributit profesional në përmirësimin e kornizës ligjore, politikave, dhe praktikave të punës** që synojnë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave dhe adresimin e çështjeve të veçanta të pakicave, bazuar mbi praktikën më të mira europiane.
4. **Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional për raportimin dhe monitorimin** e zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave mbi pakicat kombëtare.

5. **Informimi dhe ndërgjegjësimi publik** mbi rolin dhe veprimtarinë e Komitetit si dhe ngritja dhe ruajtja e dialogut institucional midis Komitetit dhe përfaqësuesit e pakicave kombëtare, përfshirë OSHC-të që mbrojnë interesat e pakicave kombëtare.

1.2.3 Metodologjia

Qasja dhe metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij dokumenti është konceptuar dhe zbatuar për të siguruar përfshirje, pjesëmarrje, përgjegjshmëri, dhe një ndjenjë pronësie ndaj procesit dhe produktit final. Krahas përfshirjes aktive përgjatë të gjitha fazave të procesit të anëtarëve përfaqësues të pakicave dhe punonjësve të administratës së Komitetit të Pakicave Kombëtare (KPK), kujdes i veçantë i është kushtuar konsultimit me organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë interesat e pakicave në vend.

Faza 1: Angazhimi institucional, përgatitja e procesit dhe vlerësimi i situatës/nevojave

Gjatë kësaj faze janë rishikuar dokumente dhe është realizuar një përmbledhje e shkurtër mbi nevojën për realizimin e një plan strategjik për KPK-në. Procesi është bazuar në raportet e vlerësimit të nevojave që KPK kishte realizuar përpara nisjes së procesit të hartimit të planit. Vlerësimi i nevojave përfshiu të dhëna si për nevojat e pakicave (përgatitur nga vetë KPK) ashtu edhe për kërkesat institucionale të KPK-së, përgatitur me ndihmën e KiE-së. KPK është asistuar prej dy ekspertëve kombëtare dhe një konsulente ndërkombëtare, me qëllim identifikimin e modeleve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e planit strategjik të KPK. Tre takime punë janë organizuar mes ekspertëve të angazhuar, KPK si dhe KiE (dy fizike dhe një virtual me ekspertin ndërkombëtar).



Figura 1. Takim i parë planifikues

Faza 2: Hartimi i draft-dokumentit

Faza e dytë e punës për hartimin e dokumentit strategjik u fokusua në rishqyrtimin dhe pasurimin e diskutimit mbi nevojat dhe prioritetet e identifikuar. Për këtë u organizua një workshop me pjesëmarrjen e anëtarëve dhe stafit të KPK, i lehtësuar nga dy ekspertët kombëtarë. Workshopi u bazua tek metodologjia e analizës SWOT për të vlerësuar pikat e dobëta, ato të forta, mundësitë dhe kërcënimet në raport me prioritetet e identifikuar.



Figura 2. Workshop – vlerësimi dhe prioritizimi i nevojave

Pas workshop-it, ekspertët vijuan punën për hartimin e pjesës narrative të dokumentit strategjik. Kjo pjesë trajton aspekte të ndryshme, përfshirë kuadrin ligjor dhe të politikave, kornizën institucionale, dhe analizon sfidat, me një fokus të dedikuar tek nevojat dhe prioritetet e identifikuara. Draft dokumenti, i cili përshinte gjetjet e analizës SWOT u qarkullua për komente, sugjerime e plotësime nga të gjithë anëtarët e KPK dhe stafi, pjesë e grupit të punës.

Pas inputeve të tyre, draft-dokumentit u rishikua dhe iu shtua matrica e planit të veprimit. Më tej, një tjetër workshop konsultativ u zhvillua për të shqyrtuar dhe diskutuar në çdo detaj të gjithë draft-dokumentin dhe matricën shoqëruese. Gjatë këtij workshopi, u diskutuan dhe rivizituan elementë të ndryshëm, që nga vizioni, deri tek aktivitetet/masat potenciale, duke siguruar një rishikim të plotë të përmbajtjes së dokumentit. Ky workshop shërbeu si një mundësi për përfshirjen e gjithë anëtarëve të grupin të punës në diskutimin dhe rishikimin e elementeve specifike, duke bërë edhe ndryshimet e nevojshme.



Figura 3. Workshop 2 – nga vizionimi tek aktivitetet/masat

Faza 3: Validime, rishikime dhe finalizim i dokumentit

Pas dy workshopeve të para, draft-dokumentet u rishikuan sërish sipas komenteve dhe sugjerimeve të grupit të punës dhe ekspertës ndërkombëtare. Draft i plotë i planit strategjik u konsultua në një workshop të 3-të mes ekspertëve kombëtarë dhe grupit institucional të punës, pranë KPK-së, gjatë të cilit u bënë editime të mëtejshme. Një workshop i 4-t dhe i dedikuar u mbajt me përfaqësues të OSHC-ve të pakicave, me qëllim prezantimin e draftit të plotë të planit të veprimit dhe marrjen e inputeve nga OSHC-të. Këndvështrimet dhe prioritetet e tyre shërbyen për të përmirësuar më tej dokumentin. Ky proces interaktiv siguroi që plani strategjik të ketë një përmbajtje të plotë dhe gjithëpërfshirëse, e cila reflekton perspektivat dhe këndvështrimet e një larmishmërie aktorësh.



Figura 4. Workshop 3 – Finalizimi i matricës së planit të veprimit



Figura 5. Workshop 4 – Konsultimi i planit të veprimit me OSHC-të

Pas konsultimeve dhe rishikimeve finale, drafti i plotë dhe përfundimtar i dokumentit iu nënshtrua një faze të katërt dhe të fundit, asaj të kostimit dhe përgatitjes për zbatim, monitorim dhe vlerësim.

Faza 4: Financimi dhe zbatimi

Gjatë kësaj faze të fundit, kujdes i veçantë u kushtua aspekteve financiare të zbatimit të planit strategjik. Burimet e nevojshme, kërkesat për financim dhe alokimet buxhetore u vlerësuan për të siguruar zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e masave të propozuara. Përveç kësaj, u gjetën qasje dhe teknika të detajuara për kombinimin e buxhetit të shtetit me financimet dhe asistencën potenciale nga donatorët, me qëllim zbatimin efektiv të masave të përcaktuara në dokument.

Për të siguruar disponueshmërinë e burimeve financiare të përshtatshme për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të planifikuara u mendua dhe formulimi dhe zbatimi i një strategjie për mobilizimin e burimeve e specifikuar në planin e veprimit. Gjatë buxhetimit të Planit strategjik u mbajtën parasysh masat prioritare të mëposhtme: Rritja e kapacitetit organizativ, efektivitetit dhe efikasitetit; Tërheqja, zhvillimi dhe forcimi i burimeve njerëzore të aftë dhe produktive; Forcimi i menaxhimit dhe përfshirja e palëve të interesuara; Forcimi i kapacitetit financiar të KPK; Zbatimi i proceseve dhe procedurave efikase dhe efektive; si dhe Adoptimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK-ut) në procese të ndryshme.




Figura 6. Konsultimi i planit të veprimit gjatë fazës së kostimit

Sigurimi i burimeve financiare të nevojshme është menduar nga disa burime, sikurse janë mbështetja nga Qeveria, aktorë të tjerë dhe donatorë. Mënyrat e sigurimit të burimeve financiare do të përfshijnë, por nuk kufizohen në: Buxhetin e Shtetit dhe angazhimi dhe partneritetet me organizata dhe institucione ndërkombëtare dhe vendase.

Gjithashtu, u krijuan mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e përparimit dhe impaktit të planit strategjik. Këto përfshijnë përcaktimin e treguesve të impaktit, treguesve kryesorë të performancës, mekanizmave të raportimit dhe vlerësimit për të matur suksesin dhe efektivitetin e aktiviteteve të zbatuara.

Duke adresuar plotësisht aspektet e kostimit dhe përgatitjes për zbatim, monitorim dhe vlerësim dokumenti në këtë fazë përfundimtare u bë gati për zbatim dhe vlerësim të vazhdueshëm të rezultateve dhe përparimit drejt tyre.

1.3 Korniza Ligjore

1.3.1 Kuadri Kombëtar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)²⁵ garanton mbrojtjen e veçantë të pakicave kombëtare. Neni 3 i Kushtetutës shprehet se “bashkëjetesa dhe mirëkuptimi [...] me pakicat kombëtare janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.” Më tej, Neni 9 ndalon partitë politike dhe organizatat që nxitin e përkrahin urrejtjes racore, fetare, krahinore ose etnike.

Për më tepër, sipas Nenit 15/2, organet e pushtetit publik duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Neni 17 garanton se kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë pa cenuar thelbin e lirive dhe të të drejtave. Këto kufizime në asnjë rast nuk duhet të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas interpretimit që bën Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Neni 18 sanksionon barazinë para ligjit të të gjithë personave dhe ndalon diskriminimin e padrejtë (të paarsyeshëm dhe jo-objektive) për shkaqe të tilla si raca, feja, etnia, gjuha, etj. Në mënyrë specifike, Neni 20 parashikon se “Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t’i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.”

Këto parashikime, tregojnë qartë se mbrojtja e pakicave kombëtare është një detyrim kushtetues i cili orienton edhe rregullimet specifike që bëjnë kodet dhe ligjet e veçanta.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë²⁶ parashikon mbrojtjen e bashkëjetesës dhe mirëkuptimin me pakicat kombëtare. Kodi përfshin vepra penale të caktuara si dhe dënime që synojnë parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, përfshirë ato të cilat lidhen me krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes për shkak të përkatësisë racore dhe etnike. Shembuj të këtyre veprave përfshijnë kanosjen me motive racizmi dhe ksenofobie (Neni 84/a), fyerjen me motive raciste ose ksenofobie (Neni 119/c), shkeljen e barazisë së shtetasve (Neni 253), nxitjen e urrejtjes ose grindjeve për shkaqe racore apo etnike (Neni 265), thirrjen për urrejtje racore apo etnike (Neni 266). Po ashtu, Kodi i konsideron motivet etnike dhe racore si rrethana rënduese në kryerjen e çdo veprë penale (Neni 50).

Ligji Për mbrojtjen nga diskriminimi²⁷ rregullon zbatimin e parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, etj. Ky ligj është i përafruar plotësisht, me Direktivën e BE-së për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike dhe parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës. (Neni 1). Ligji ndalon çdo dallim, kufizim ose përjashtim që lidhet me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën etj., ndërkohë, lejon për zbatimin e masave të posaçme dhe të përkohshme, me qëllim ofrimin e mundësive të barabarta në fusha të caktuara si arsimit, të cilat nuk konsiderohen diskriminim (Neni 17). Këshilli i Ministrave dhe Ministria përgjegjëse ka detyrimin për marrjen e masave për arsimimin në gjuhët e pakicave. (Neni 18) Ligji i jep kompetencë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndër të tjera, (i) të shqyrtojë ankesat nga personat ose

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar)

²⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (Ligj Nr. 7895/1995, i ndryshuar 2021).

²⁷ Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2020 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar me ligjin nr. 124/2020 datë 15.10.2020.

grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, (ii) të vendosë sanksione administrative, (iii) të rekomandojë duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin e reformimit të legjislacionit ekzistues, (iv) të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit duke ofruar informacione për këtë ligj edhe në gjuhët e pakicave (v) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur cenohen të drejtat dhe liritë themelore të individëve, si dhe (vi) të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji. (Neni 32)

Ligji Për Gjendjen Civile²⁸ përcakton përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve (Neni 6), duke përjashtuar elementin e kombësisë si një nga përbërësit e gjendjes civile. **Gjykata Kushtetuese në dhjetor 2011** ka vendosur të shfuqizojë termat “kombësi” apo “kombësi e prindërve” në ligjin për gjendjen civile, pasi cenon parimin e sigurisë juridike dhe bien në kundërshtim me nenet 20 dhe 35 të Kushtetutës. Gjykata argumentoi se regjistrimi i të dhënave mbi ‘kombësinë’ në regjistrat e gjendjes civile, ndërhyr në sferën e jetës private të individit dhe shkel parimin kushtetues të mosdetyrimit të bërjes publike të të dhënave personale, ku përfshihen dhe të dhënat personale ‘sensitive’. Gjykata sugjeroi mbledhjen e të dhënave demografike, të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe social apo për qëllime të politikave shtetërore për të nxitur ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të pakicave etnike, nëpërmjet procedurave të tjera, në përputhje me garancitë ligjore që parandalojnë shpërdorimin e të dhënave.²⁹

Si rezultat, ky vendim i Gjykatës Kushtetuese praktikisht bën të pazbatueshëm, si të papajtueshëm me Kushtetutën, Nenin 7, paragrafin 1 të ligjit 97/2017 për pakicat kombëtare, i cili kërkon identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare bazuar tek dokumentacioni i Gjendjes Civile.

Ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”³⁰, përkufizon të dhënat sensitive, ku përfshihet “çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, .” ndër faktorëve të tjerë. (Neni 3/2) Sipas Nenit 7, përpunimi i të dhënave që zbulojnë origjinën racore ose etnike lejohet vetëm në rastet kur: i) subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin; ii) është në interesin jetik të subjektit të të dhënave dhe subjekti është fizikisht ose mendërisht i paafte për të dhënë pëlqimin e vet; iii) autorizohet nga autoriteti përgjegjës për një interes të rëndësishëm publik; iv) të dhënat janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave, ose është i nevojshëm për ushtrimin apo mbrojtjen e një të drejte ligjore; v) të dhënat përpunohen për kërkime shkencore ose statistikore; vi) të dhënat kërkohen për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit mjekësor (në këto raste personeli mjekësor ka detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë; vii) organizatat jofitimprurëse i përpunojnë të dhënat vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre dhe vetëm për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme duke pasur detyrimin të mos i bëjnë të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj; dhe së fundi viii) përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe të të drejtave specifike të kontrolluesit në fushën e punësimit, në përputhje me Kodin e Punës”. (Neni 7)

Siç vërehet nga këto parashikime ligjore, të dhënat personale “sensitive”, ku përfshihen përkatësia racore dhe etnike, gëzojnë një mbrojtje të veçantë për shkak të karakterit të tyre privat dhe entet publike duhet të sigurojnë se përdorimi i këtyre të dhënave është në përputhje me parashikimet ligjore.

Ligji Nr. 140/2020 Për censin e popullsisë dhe të banesave³¹ lejon pyetje për identifikimin etnik, gjuhën dhe fenë, në pyetësorët e censit. Për këto pyetje, përgjigjet bazohen në deklarin e lirë dhe jo të detyrueshëm të individit. Këto pyetje duhet të përmbajnë edhe alternativën për t’iu përgjigjur ‘Unë

²⁸ Ligji Nr. 10129 datë 11.05.2009 Për Gjendjen Civile, i ndryshuar.

²⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52 datë 1.12.2011.

³⁰ Ligji Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale.

³¹ Ligji Nr. 140/2020 Për censin e popullsisë dhe të banesave.

preferoj të mos përgjigjem³² (Neni 4). Sipas ligjit, të dhënat e mbledhura nga censi përdoren vetëm për qëllime statistikore, dhe regjistrat statistikorë të krijuar për këtë qëllim mirëmbahen dhe administrohen vetëm nga INSTAT-i dhe nuk përdoren për asnjë listë elektorale apo përditësimin e ndonjë regjistri civil ose regjistri tjetër administrativ (Neni 8 paragrafi 2 dhe 4). Për më tepër, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave të censit garantohen nga legjislacionit për statistikën zyrtare dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Çdo person apo autoritet publik, i përfshirë në proceset e censit ka i detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to. INSTAT-i ruan të dhënat e mbledhura të censit sipas parashikimeve në legjislacionin për statistikën zyrtare (Neni 9 paragrafi 1 – 7).

Nga parashikimet e mësipërme, është e qartë se të dhënat e censit gëzojnë një mbrojtje të veçantë dhe përdoren ekskluzivisht vetëm për qëllime statistikore e jo për të identifikuar individualisht personat që u përkasin pakicave kombëtare.

Ligji “Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë”³³ përcakton rregullat, procedurat dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, në territorin e Republikës së Shqipërisë (Neni 1 dhe 2). Sipas ligjit, “Vlerat e krijuara nga pakicat kombëtare në Shqipëri konsiderohen si pjesë të trashëgimisë kulturore jomateriale” (Neni 16, paragrafi 2). Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore ndërmerr nisma për njohjen në nivel ndërkombëtar të vlerave kulturore jomateriale, si dhe për regjistrimin e këtyre vlerave në listën përfaqësuese të dukurive jomateriale të UNESCO-s, pas miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (Neni 17).

Ligji parashikon financime për trashëgiminë kulturore nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, ndërsa lejon donacione ose sponsorizime të ligjshme (Neni 20). Ky ligj gjithashtu parashikon edukimin përmes trashëgimisë kulturore jomateriale. Kështu, ministria përgjegjëse e trashëgimisë kulturore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, merr masa të veçanta për të siguruar transmetimin e trashëgimisë kulturore jomateriale tek brezat e rinj, si edhe për të respektuar diversitetin kulturor të pakicave kombëtare dhe mbështetur programet edukative dhe ndërgjegjësuese. Kjo realizohet nëpërmjet realizimit të botimeve edukative dhe sensibilizuese shkollore e jashtëshkollore; programeve të posaçme edukative të trajnimit; dhe programeve informuese dhe sensibilizuese për publikun, sidomos tek të rinjtë. Masat specifike për njohjen, respektimin, përhapjen dhe vlerësimin e kësaj fushe të trashëgimisë kulturore miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore (Neni 105).

Parashikimet e mësipërme theksojnë rëndësinë e bashkërendimit të punës ndërmjet Komitetit dhe ministrive përgjegjëse për kulturën dhe arsimin, për të siguruar mbrojtjen dhe edukimin me trashëgiminë kulturore të vendit.

Ligji për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë³⁴ rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas ligjit, Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) është përgjegjës për hartimin e planit të përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetimet audio, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave (Neni 59, paragrafi 1). Gjatë shqyrtimit të aplikimeve dhe vendimmarrjes për përzgjedhjen e aplikuesit fitues për dhënien e licencave të transmetimeve audio për rrjete analoge dhe të shërbimit të programeve audio e audiovizive,

³² Ligji i mëparshëm parashikonte gjobë për deklaram të rremë.

³³ Ligji Nr. 27/2018 Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë: <https://www.bksh.al/bksh/Ligje/Ligji.nr27-dt.17-05-2018.pdf> ; për ndryshimet shih: <https://exit.al/ligji-i-ri-per-median-zgjeron-me-shume-kontrollin-e-geverise/>

³⁴ Ligji Nr. 97/2013 për mediat audiovizive në RSH, i ndryshuar deri në 2022: <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/99706/119118/F-1658809941/ALB-99706.pdf>

AMA mban parasysh edhe gatishmërinë për të ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në hapësirën e mbulimit për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave (Neni 61). Për më tepër, RTSH-ja synon të sigurojë shërbime cilësore radioje dhe televizioni që informojnë, edukojnë dhe argëtojnë publikun, duke i shërbyer të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare (Neni 91). Ndër qëllimet kryesore të veprimtarisë së RTSH-së përfshihet edhe sigurimi i një game të plotë të programeve në gjuhën shqipe, që pasqyrojnë larminë kulturore, dhe plotësojnë pritshmëritë e publikut në përgjithësi, si dhe të individëve, që i përkasin pakicave shoqërore, duke respektuar në çdo rast dinjitetin njerëzor (Neni 118). Këto parashikime tregojnë nevojën e bashkëpunimit të Komitetit edhe me autoritetin e AMA dhe RTSH-në.

Ligji për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë³⁵ e shtrin veprimin e vet në të gjithë rrjetin e bibliotekave që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga forma e pronës dhe përkatësia institucionale. Ky ligji parashikon se bibliotekat publike vendore duhet të organizojnë shërbime të veçanta për anëtarë të bashkësisë që, për arsye të ndryshme, nuk kanë mundësi të përdorin shërbimet e zakonshme si, minoritetet gjuhësore (pakicat kombëtare) (Neni 28, paragrafi 7).

Ligji 96/2018 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” garanton ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare duke konkretizuar parimet e parashikuara në Kushtetutë dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me ligjin nr. 8494 datë 3.6.1999. Ligji jep përkufizimin e pakicave kombëtare³⁶ dhe njeh shprehimisht nëntë pakica kombëtare ku përfshihen pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare, ndërsa lejon edhe mundësinë për njohjen edhe të pakicave të tjera në të ardhmen. Sipas ligjit, të drejtat dhe liritë e personave që u përkasin pakicave kombëtare ushtrohen bazuar mbi parime të tilla si, zgjedhja e lirë (pa u ndaluar dhe as detyruar) për t’u trajtuar ose jo si anëtar i një pakice, vetidentifikimi në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale,³⁷ ndalimin e diskriminimit dhe ofrimin e mundësive të barabarta, si dhe nxitjen e respektit të ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e të gjithë qytetarëve të Republikës. (Nenet 5- 8)

Personave që u përkasin pakicave kombëtare u garantohen dhe gëzojnë disa të drejta specifike ku përfshihen: liria e organizimit dhe e drejta e përfaqësimit (Neni 9), liria e ndërgjegjes dhe e fesë (Neni 10), pjesëmarrja në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike (Neni 11), ruajtja e identitetit kulturor (Neni 12), të mësojnë gjuhën dhe të mësohen në gjuhën e pakicës (Neni 13), liria e shprehjes, e mendimit dhe e drejta e informimit (Neni 14), dhe përdorimi i gjuhës (Neni 15), të drejtën për të vendosur dhe mbajtur kontakte të lira e paqësore përtej kufijve me personat me të cilët kanë të njëjtin identitet etnik, gjuhësor, feta ose një trashëgimi të përbashkët (Neni 17). Për më tepër, Republika e Shqipërisë mund të

³⁵ Ligji për bibliotekat në RSH, https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/LIGJ_Nr.8576_date_3.2.2000_PER_BIBLIOTEKAT_NE_REPUBLIKEN_E_SHQIPERISE.pdf; <https://www.bksh.al/legjislacioni/ligji> (ndryshime 2004)

³⁶ Sipas Nenit 3 (1) të Ligjit, pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë që kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me shtetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. (theks i shtuar).

³⁷ Interpretimi i Nenit 7 pjesa që përcakton se institucionet publike “mbledhin të dhëna për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare bazuar në të drejtën e vetidentifikimit dhe dokumentacionin e Gjendjes Civile”, duhet interpretuar në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk lejon mbledhjen e të dhënave mbi pakicat kombëtare përmes Regjistrat të Gjendjes Civile.

lidhë marrëveshje ndërkombëtare me shtete të tjera për të siguruar mbrojtjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, sipas Nenit 17 pika 2.

Ligji krijon **Komitetin për Pakicat Kombëtare**³⁸, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit (Neni 18). Komiteti ka autoritet të : a) rekomandojë dhe japë opinionin e tij në lidhje me hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare; b) propozojë rekomandime për Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit vendor për trajtimin e çështjeve që lidhen me pakicat kombëtare; c) përgatisë dhe dorëzojë raporte periodike për Kuvendin për gjendjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë; ç) bashkëpunojë dhe koordinojë me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor raportimin dhe monitorimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave shtetërore në lidhje me pakicat kombëtare; d) organizojë aktivitete, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare; dh) kontribuojë në përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; e) ndërmarr aktivitete, të cilat kanë si synim përmbushjen e angazhimeve dhe detyrimeve ndërkombëtare; ë) japë opinione në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare; f) japë opinion pranë institucionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 3, të këtij ligji, lidhur me kërkesat për njohjen e pakicave; g) financojë, nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare, nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të pakicave kombëtare.

Komiteti përbëhet nga anëtarët përfaqësues të nëntë pakicave kombëtare, të cilët emërohen me urdhër të Kryeministrit për një mandat katër vjeçar të ripërtëritshëm. Emërimet mbështeten në kandidaturat e paraqitura nga organizatat që përfaqësojnë pakicat kombëtare.

Aktet e miratuara nënligjore të Ligjit 96/2017³⁹:

1. VKM Nr. 561, datë 29.9.2018 Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”.
2. VKM Nr. 562, datë 29.9.2018 “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të ët të lartë”
3. VKM Nr. 726, datë 12.12.2018 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare”.
4. VKM Nr. 227, datë 17.04.2019 “Mbi përgatitjen, botimin, publikimin dhe shpërndarjen e teksteve të ët të nxënësve, që u përkasin pakicave kombëtare në sistemin arsimor bazë parauniversitar”.
5. VKM Nr.286, datë 10.05.2019 “Për miratimin e procedurave të zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit të Pakicave Kombëtare”.
6. VKM Nr.462, datë 3.07.2019 “Për miratimin e masave dhe të politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë”

³⁸ Ky institucion zëvendësoi Komitetin Shtetëror të Minoriteteve, i krijuar me vendimin nr. 27, datë 11.03.2004 të Këshillit të Ministrave I cili I ushtron funksionet e tij deri në momentin e krijimit të Komitetit të Pakicave Kombëtare sipas parashikimit të Nenit 18 të ligjit nr. 96/2017.

³⁹ Teksti i plotë i këtyre akteve nënligjore gjendet në webfaqen e KPK-së:

http://www.pakicatkombetare.gov.al/?page_id=432

7. VKM Nr. 463, datë 3.07.2019 “Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre.

8. VKM Nr.1155 datë 24.12.2020 “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”. Aktualisht janë në proces hartimi dhe konsultimi përfundimtar 3 projektvendime.

9. VKM Nr. 769 datë 15.12.2021 “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e fondit për pakicat kombëtare”;

Projekt-aktet nënligjore që priten të miratohen në kuadrin e Ligjit Nr. 96/2017:

1. Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr.96/2017)”.
2. Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.
3. Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetë-identifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, Informacion i detajuar mbi përmbajtjen e akteve nënligjore jepet në vijim, në pjesën e tretë të Raportit. lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe aktet nënligjore të tij parashikojnë që Komiteti të zhvillojë hulumtime dhe të përdorë ekspertizë në fusha të ndryshme. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në fusha të tilla si arsimi, kultura, zhvillimi institucional, shpërndarja e informacionit, advokimi, pjesëmarrja e grupeve të pakicave në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike, çështjet gjuhësore të lidhura me pakicat, rolin e njësive të qeverisjes vendore, mbledhjen e të dhënave sensitive në lidhje me pakicat, vetidentifikimin e personave që i përkasin pakicave të njohura, apo njohjen e grupeve tjera minoritare.

1.3.2 Kuadri Ndërkombëtar

Kombet e Bashkuara

Të Drejtat e Pakicave janë pjesë integrale e punës së Kombeve të Bashkuara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zhvillimit të qëndrueshëm njerëzor, paqes dhe sigurisë. OHCHR ka rolin kryesor brenda sistemit të Kombeve të Bashkuar në këtë drejtim. OHCHR është bashkë-kryesuese e Rrjetit të Kombeve të Bashkuara mbi Diskriminimin Racial dhe Mbrojtjes së Pakicave. Rrjeti, i krijuar në 2012, bën bashkë më shumë se 20 agjenci, programe, dhe fonde të OKB-së për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun mbi çështjet e pakicave në sistemin e OKB-së.⁴⁰

Mbrojtja e të drejtave të pakicave parashikohet në nenin 27 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 30 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Deklarata e Kombeve të Bashkuara

⁴⁰ Shih <https://www.ohchr.org/en/minorities/about-minorities-and-human-rights>.

për të Drejtat e Personave që u përkasin pakicave kombëtare ose etnike, fetare dhe gjuhësore⁴¹ është dokumenti që përcakton standardet thelbësore dhe u ofron udhëzime shteteve në miratimin e masave të përshtatshme legislative dhe masave të tjera për të siguruar të drejtat e personave që u përkasin pakicave.⁴²

Shtylla themelore e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes ligjore të pakicave janë parimet e mosdiskriminimit dhe barazisë, të cilat përbëjnë bazën e të gjitha traktateve thelbësore të të drejtave të njeriut. Ato zbatohen për të gjithë në lidhje me të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut dhe ndalojnë diskriminimin në bazë të një liste kategorish jo shteruese si raca, ngjyra, feja, gjuha, kombësia dhe etnia ose prejardhja e punës. Nëpërmjet respektimit të këtyre dy parimeve, mund të sigurohet gëzimi i shumë të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtën për pjesëmarrje efektive në vendimmarrje nga minoritetet dhe në veçanti nga gratë e pakicave.

Bashkimi Evropian

Traktati i Lisbonës prezantoi termin ‘personat që u përkasin pakicave’ në dokumentet themelore të së drejtës së BE-së ndërsa Neni 2 i Traktatit të BE-së thekson se “Unioni është themeluar mbi parimet e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e së drejtës dhe respektin për të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave” dhe “këto parime janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare”. Ndërkohë, Parlamenti Evropian në vitin 2018 ka miratuar rezolutën mbi **Standardet Minimum për Pakicat në BE**, përmes së cilët i bën thirrje Komisionit të përgatisë një kuadër të përbashkët mbi mbrojtjen e pakicave ku të përcaktohen praktikat më të mire, të hartohet në rekomandim nga Komisioni lidhur mbi këtë çështje, si dhe të propozohet një direktivë përkatëse. (paragrafi 78). Në paragrafin 79 u bën thirrje Shteteve Anëtare dhe atyre kandidatë për të siguruar vënien në zbatim të këtyre standardeve.⁴³ Shtetet anëtare të BE-së janë palë kontraktuese të Këshillit të Evropës madje vetë BE është angazhuar për zbatimin e standardeve të Këshillit të Evropës edhe në nivel unioni.

Këshilli i Evropës

Këshilli i Evropës garanton mbrojtjen e të drejtave të pakicave përmes disa mekanizmave.⁴⁴ Krahës Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, hartuar posaçërisht për atë qëllim, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1950)

KEDNJ është në fuqi prej vitit 1953 dhe është rishikuar disa herë përmes një numri protokollesh. Që nga viti 1998, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut funksionon si një gjykatë e përhershme e cila bën interpretimin e Konventës. Edhe pse nuk përmban të drejtat e pakicave nuk përmenden në mënyrë të shprehur, është krijuar një praktikë gjyqësore përmes së cilës të drejtat e garantuara nga Konventa u janë njohur edhe personave që u përkasin pakicave kombëtare. Përmes jurisprudencës së GJEDNJ-së është

⁴¹ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave (1992) (A/RES/47/135)

⁴² Shih listën e instrumenteve ndërkombëtar të të drejtave të njeriut të miratuara nga Shqipëria: <https://indicators.ohchr.org/>.

⁴³ Minimum standards for minorities in the EU: European Parliament resolution of 13 November 18 on minimum standards for minorities in the EU (2018/2036(INI).

⁴⁴ Këshilli i Evropës është një organizatë ndër-qeveritare me 47 anëtare (momentalisht 46 anëtare pasi Rusia është pezulluar) dhe nuk duhet ngatërruar me Bashkimin Evropian i cili është një organizatë me natyrë mbi-qeveritare apo mbi-kombëtare (supranational) me 27 shtete anëtare, edhe pse këto të fundit janë të gjitha janë gjithashtu anëtare të Këshillit të Evropës.

zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme mbrojtja ligjore e pakicave kombëtare. Kjo manifestohet, ndër të tjera, në ndikimin e ndërsjellë midis Gjykatës dhe Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër që pasqyrohet në disa vendime të Gjykatës dhe opinione të Komitetit Këshillimor. Disa prej vendimeve më me ndikim të Gjykatës në fushën e pakicave përfshijnë ato mbi **të drejtën për vetidentifikim**, ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues, paprekshmërinë e banesës, të drejtën e jetës private, lirinë e shprehjes, lirinë e besimit fetar, lirinë e mbledhjes dhe organizimit, të drejtën për gëzimin paqësor të pronës, të drejtën për arsim, të drejtën për zgjedhje të lira, dhe ndalimin e diskriminimit.⁴⁵

E vetmja referencë për pakicat gjendet në Nenin 14 të Konventës i cili parashikon se “gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë duhet të sigurohet pa diskriminim për asnjë shkak duke përfshirë, seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, pikëpamjet politike ose opinion tjetër, origjinën kombëtare ose sociale, përkatësinë në një pakicë kombëtare, pronësinë, lindjen ose statusin tjetër.” *Protokolli 12 i Konventës* (miratuar në 4 nëntor, 2000 dhe në fuqi prej 1 prillit 2005)⁴⁶ ndaloj diskriminimin jo vetëm për të drejtat dhe liritë e parashikuara në KEDNJ por vendosi të drejtën e përgjithshme për ndalimin e diskriminimit mbi çdo të drejtë tjetër parashikuar me ligj ose çdo autoritet tjetër publik. E drejta e përgjithshme për mosdiskriminim përbënë një mjet themelor për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Diskriminimi nuk kufizohet vetëm tek rastet ku një person ose grup trajtohet më keq se një tjetër grup i ngjashëm. Mund të përbëjë gjithashtu diskriminim kur trajtohen njëloj grupe të ndryshme: të trajtosh një pakicë dhe një shumicë njëloj mund të përbëjë diskriminim kundër pakicës. Për më tepër, GJEDNJ ka theksuar se nëse një shtet ndërmerr masa pozitive për të përmirësuar statusin e ndonjë komuniteti pakice (për shembull, në lidhje me pjesëmarrjen në proceset demokratike), shumica nuk mund të pretendojë diskriminim bazuar mbi këto masa.⁴⁷

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

Konventa Kuadër është miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës në 1994 dhe hyri në fuqi në 1998. Është instrumenti i parë shumëpalësh me fuqi ligjore detyruese kushtuar mbrojtjes së pakicave dhe konsiderohet si standardi më gjithëpërfshirës ndërkombëtar i deritanishëm në fushën e të drejtave të pakicave.

Konventa përmban dispozita programatike që krijojnë parime dhe objektiva të cilat duhet të udhëheqin Shtetet në mbrojtjen e popullsisë të tyre pakicë. Për këtë qëllim, Konventa është konceptuar si një seri detyrimesh nga ana e shteteve se sa një listë e detajuar të drejtash për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Përmbushja e këtyre parimeve dhe objektivave duhet të bëhet në nivel kombëtar, veçanërisht përmes miratimit të legjislacionit dhe politikave përkatëse.

Dy prej parimeve themelore të parashikuara në Konventën Kuadër janë Neni 1, i cili parashikon se mbrojtja e pakicave kombëtare është pjesë integrale e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe Neni 22, i cili specifikon se Konventa nuk mund të interpretohet për të ulur standardet ekzistuese të mbrojtjes. Meqenëse ajo është konceptuar si një shtojcë ndaj mekanizmave ekzistues për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të drejtave të pakicave, ajo duhet të lexohet në lidhje me këto instrumente, dhe veçanërisht KEDNJ. Neni 4.1 i Konventës parashikon parimet themelore të mosdiskriminimit dhe barazisë. Neni 4.2

⁴⁵ Shih Judgments of the European Court of Human Rights: Selection of judgments of the European Court of Human Rights relevant for the protection of national minorities, at: <https://www.coe.int/en/web/minorities/judgments-of-the-european-court-of-human-rights>.

⁴⁶ European Treaty Series No. 177.

⁴⁷ Shih, ndër të tjera, <https://www.coe.int/en/web/minorities/role-of-ngos>; <https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>; dhe Pamphlet No. 7 of the UN Guide for Minorities, at: www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/GuideMinorities7en.pdf.

qartëson se detyrimet e një shteti mund të kërkojnë ndërmarrjen e masave pozitive nga ana e qeverisë dhe jo thjesht abstenimin nga diskriminimi. Kur është e nevojshme, shtetet duhet të ndërmarrin masa për të promovuar “barazinë e plotë dhe efektive midis personave që u përkasin a një pakice kombëtare dhe atyre që u përkasin popullsisë shumicë” duke “marrë një konsideratë kushtet specifike” të pakicave. Neni 4.3 qartëson se çdo masë e marrë për të promovuar barazinë efektive nuk mund të konsiderohen në vetvete si diskriminim.

Pjesa tjetër e dispozitave përmbajtësore përfshijnë një shumëllojshmëri çështjesh shumica e të cilave kërkon që shtetet të miratojnë masa specifike, ndër to, për të promovuar kushtet e nevojshme për pakicat që të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre (Neni 5), inkurajojnë tolerancën, respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin ndërmjet të gjithë personave që jetojnë në territorin e tyre (Neni 6), mbrojnë të drejtën e mbledhjes, organizimit, shprehjes, mendimit, ndërgjegjes, dhe fesë (Nenet 7, 8 dhe 9); lehtësimin e aksesit në mediat kryesore dhe promovimi i krijimit dhe funksionimit të medias së pakicave (Neni 9); njohin të drejtën për të përdorur gjuhën e pakicës në jetën private dhe publike dhe shfaqjen e informacionit në gjuhën e pakicave (Nenet 10 dhe 11); njohin zyrtarisht emrat dhe mbiemrat në gjuhën e pakicës (Neni 11); përpiqen për të siguruar të drejtën e përdorimit të gjuhës së pakicës përpara autoriteteve administrative (Neni 10 dhe 11); mbështesin njohjen e kulturës, historisë, gjuhës, dhe fesë edhe të popullsisë shumicë edhe pakicave (Neni 12); njohjen e të drejtave të pakicave për të themeluar dhe administruar institucione arsimore të pakicave dhe të mësojnë gjuhën e pakicave (Neni 13 dhe 14); përpiqen të sigurojnë mundësi të përshtatshme për tu mësuar në gjuhën e tyre të pakicës (Neni 14); krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen efektive të personave që u përkasin pakicave kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike, dhe në punët publike, veçanërisht ato të cilat kanë ndikim mbi ta (Neni 15); të mos marrin masa që ndryshojnë përbërjen e popullsisë në zonat e banuara nga pakicat (Neni 16); të mos ndërhyjnë në të drejtat për të mbajtur kontakte përtej kufijve dhe marrë pjesë në veprimtaritë e OJQ-ve kombëtare dhe ndërkombëtare (Neni 17).

Nenet 24 – 26 të Konventës Kuadër krijojnë mekanizmin monitorues të saj. Shtetet janë të detyruara të paraqesin raporte periodike për shqyrtim nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, por një **Komitet Këshillues ekspertësh** asiston Komitetin e Ministrave. Ndryshe nga KEDNJ, nuk ka ndonjë procedurë që lejon për ankime individuale. Raportet e shteteve fillimisht shqyrtohen nga Komiteti Këshillues i ekspertëve, i cili vlerëson përshtatshmërinë e masave të ndërmarra nga Shteti dhe jep “opinionin” mbi raportet. Komiteti i Ministrave merr në konsideratë *raportet e shteteve dhe opinionet e Komitetit Këshillues të ekspertëve* përpara se të miratojë *konkluzionet* e veta mbi zbatimin e Konventës Kuadër. Opinionet e Komitetit Këshillues janë konfidenciale derisa Komiteti i Ministrave nxjerr konkluzionet e tij, kohë në të cilën vërejtjet e të dy komiteteve publikohen. Krahas Komitetit Këshillues të ekspertëve, **OJQ-të kanë një rol thelbësor** në zbatimin e plotë të parimeve të Konventës Kuadër përmes përfshirjen e tyre si në procesin e zbatimit ashtu edhe në atë të monitorimit.⁴⁸

Karta Evropiane për Gjuhët e Pakicave dhe Rajonale

Karta Evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave është konventa evropiane për mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve të përdorura nga pakicat tradicionale. Së bashku me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ajo përbën angazhimin e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Gjuhët rajonale ose të pakicave janë pjesë e trashëgimisë kulturore të Evropës dhe mbrojtja dhe promovimi i tyre kontribuojnë në ndërtimin e një Evrope të bazuar në demokraci dhe diversitet kulturor. Karta, e hartuar në bazë të një teksti të paraqitur nga Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, u miratua si një konventë më 25 qershor 1992 nga Komiteti i Ministrave

⁴⁸Shih, ndër të tjera, Pamphlet No. 8 of the UN Guide for Minorities, at: <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/GuideMinorities8en.pdf>.

të Këshillit të Evropës dhe u hap për nënshkrim. në Strasburg më 5 nëntor 1992. Ka hyrë në fuqi më 1 mars 1998. Zbatimi i Kartës monitorohet nga një komitet ekspertësh të pavarur. Më 28 nëntor 2018, deputetët e ministrave miratuan ndryshimet që do të bëhen në funksionimin e mekanizmit monitorues të Kartës me synim forcimin e tij. Këto hynë në fuqi më 1 korrik 2019.⁴⁹

Nëntë Rekomandimet dhe Udhërrëfyesit e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare

Rekomandimet dhe Udhërrëfyesit Tematike të Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare u drejtohen politikë-bërësve dhe përfaqësuesve të Shteteve duke ofruar udhëzime mbi zhvillimin e politikave që mund të lehtësojnë tensionet ndër-etnike. **Këto nëntë dokumente përfshijnë:** (1) Udhërrëfyesin e Tallinn-it mbi Pakicat Kombëtare dhe Median në Epokën Digjitale; (2) Rekomandimet e Graz-it mbi Aksesin në Drejtësi dhe Pakicat Kombëtare; (3) Udhërrëfyesi i Lubjanës mbi Integrimin e Shoqërive Diverse; (4) Rekomandimet e Bolzano-s mbi Pakicat Kombëtare në Marrëdhëniet Ndër-Shtetërore; (5) Rekomandime mbi Policimin në Shoqëritë Shumë-Etnike; (6) Udhërrëfyesi mbi Përdorimin e Gjuhës së Pakicës në Transmetimin Mediatik; (7) Rekomandimet e Lund-it mbi Pjesëmarrjen Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike; (8) Rekomandimet e Oslo-s lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare; (9) Rekomandimet e Hague-s lidhur me të Drejtat Arsimore të Pakicave Kombëtare.⁵⁰

Komiteti Këshillues i Ekspertëve mbi Konventën Kuadër të Pakicave Kombëtare

Bazuar në nenin 25 (pika 1 dhe pika 2) të Konventës Kuadër prej vitit 2001, Shqipëria ka paraqitur periodikisht pranë Këshillit të Evropës, pesë raporte periodike mbi zbatimin e dispozitave të Konventës Kuadër, mbi respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Shqipëri. Në kuadrin e cikleve periodike të monitorimit, pas paraqitjes së Raporteve kombëtare periodike janë miratuar Opinionet përkatëse të Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër. Pas shqyrtimit të Opinioneve përkatëse të Komitetit Këshillues⁵¹ dhe paraqitjes së komenteve të autoriteteve shqiptare mbi këto Opinione, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar rezolutat përkatëse mbi zbatimin e Konventës Kuadër nga Shqipëria. Opinionet e Komitetit Këshillues të Konventës Kuadër janë përkthyer edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Pas publikimit të Opinionit të katërt, në bashkëpunim edhe me Zyrën e Këshillit të Evropës, në kuadër të zbatimit të fazës së dytë të Instrumentit Horizontal Facility për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 (*Horizontal Facility for the Western Balkans and Turkey*), do të bëhet i mundur përkthimi i këtij Opinioni edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Raporti i Pestë i Shqipërisë përmban masa për zbatimin e Konventës, për adresimin e problematikave të identifikuar në ciklin e mëparshëm, si dhe zbatimin e të drejtave edhe në nivel

⁴⁹ Gjatë anëtarësimit në Këshillin e Evropës, Shqipëria u angazhua për nënshkrimin dhe ratifikimin e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, por ende nuk e ka bërë këtë. Në 2018 dhe 2019, Këshilli i Evropës, duke u mbështetur në 'Facilitetin Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë,' financuar nga Bashkimi Evropian, ndihmoi autoritetet shqiptare që, ndër të tjera, të rishikojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre vendase për pajtueshmërinë me Kartën dhe për të përgatitur një projekt-instrument ratifikimi që përfshin angazhimet e përzgjedhura të Kartës në përputhje me angazhimin e saj pas anëtarësimit.

⁵⁰ Shih_Nëntë Rekomandimet dhe Udhërrëfyesit e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare: <https://www.osce.org/hcnm/thematic-recommendations-and-guidelines>.

⁵¹ Opinioni i parë i Komitetit Këshillues miratuar në shtator 2002 (ACFC/INF/OP/I(2003)004); Opinioni i dytë miratuar në maj 2008 (ACFC/OP/II(2008)003); Opinioni i tretë miratuar në nëntor 2011 (ACFC/OP/III(2011)009). Opinioni i katërt miratuar 11 tetor 2018 dhe publikuar në maj 2019 (ACFC/OP/IV(2018)006). Opinionet e cikleve të mëparshme, përfshirë edhe Opinioni e ciklit të katërt gjenden në faqen e internetit: <https://www.coe.int/en/web/minorities/albania>.

vendor.⁵² Ministritë dhe institucionet kompetente, sipas fushave, informojnë periodikisht Ministrinë për Evropën dhe Punët të Jashtme (MEPJ), në kuadrin e hartimit të raporteve kombëtare për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, dhe në këtë kuadër Komiteti gjithashtu përfshihet në këtë proces.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) është themeluar nga Këshilli i Evropës dhe funksionon si organ i pavarur i specializuar në monitorimin e për të drejtat e njeriut e kryesisht çështjet e lidhura me luftën kundër racizmit, diskriminimit, ksenofobisë, antisemitizmit, antixhipsizmit (diskriminim racial kundër romëve dhe egjiptianëve) dhe intolerancës. Në këtë kuadër, ECRI kryen analiza monitoruese në secilin prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës lidhur me gjendjen e racizmit dhe intolerancës, dhe harton sugjerime dhe propozime për trajtimin e problemeve të identifikuara.⁵³

Raport i gjashtë i ECRI-t mbi Shqipërinë 2020⁵⁴, siç u theksua më sipër në seksionin e analizës së situatës, vendos theksin kryesisht tek zbatimi dhe monitorimi i masave lidhur me aksesin në drejtësi, luftën kundër dhunës dhe gjuhës së urrejtjes, si dhe përfshirjes së pakicave romë dhe egjiptiane.

1.3.3 Lidhja me Dokumentet Strategjik

Kuadri i politikave për mbrojtjen e pakicave kombëtare përbëhet nga strategji sektorale e ndërsektorale, si dhe me dokumente të tjera të politikave që ndërlidhen me të drejtat e njeriut siç janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030 (SKZHI III), Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2022-2024, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, Strategjia Kombëtare Kulturore 2019-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021 – 2025. Po ashtu, në kuadrin e politikave bëjnë pjesë edhe dokumente ndërkombëtare në hartimin e të cilave ka marrë pjesë Republika e Shqipërisë, si Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në vijim do të prezantojmë një përshkrim të shkurtër të dokumenteve kryesore të politikave mbi të cilat mbështetet Plan Strategjik për Zhvillimin Institucional të Komitetit për Pakicat Kombëtare 2023–2026.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021 – 2030 (SKZHI III). SKZHI 2021-2030 është dokumenti strategjik themelor i cili harmonizon dhe pajton agjendën zhvillimore me proceset integruuese të vendit duke përcaktuar vizionin, përparësitë dhe objektivat madhore kombëtare për periudhën deri në vitin 2030. Ky dokument strategjik qendror dhe orientues siguron priorizimin e politikave për strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe programeve të financimit nga Bashkimi Evropian e donatorëve të tjerë të huaj. Ndër qëllimet e SKZHI III 2021-2030 është edhe siguri i ushtrimit të të drejtave specifike të njeriut për çdo person që i përket një pakice kombëtare si një nevojë themelore në një shoqëri të integruar ku garantohet mosdiskriminimi dhe barazinë e plotë para ligjit. Në mënyrë të veçantë, SKZHI III përmend vijimësinë e punës për zbatimin e ligjit për pakicat kombëtare dhe miratimin e akteve nënligjore

⁵² Raporti i parë është paraqitur në korrik 2001; Raporti i dytë paraqitur maj 2007; Raporti i tretë paraqitur janar 2011; Raporti i katërt nëntor 2016; raporti i pestë maj 2021 në: <https://rm.coe.int/5th-sr-albania-al/1680a2614d>

⁵³ Kjo punë kryhet në bazë ciklesh prej pesë vjetësh. Raportet e raundit të parë u përfunduan në fund të vitit 1998, ato të raundit të dytë në fund të vitit 2002, ato të raundit të tretë në fund të vitit 2007, ato të raundit të katërt në fillim të vitit 2014, dhe ato të raundit të pestë në fund të vitit 2019. Puna për raportet e raundit të gjashtë ka filluar në fund të vitit 2018. Shih webfaqen e ECRI-it, në: <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania>.

⁵⁴ Shih raportin e gjashtë të ECRI-it për Shqipërinë në: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>.

që ende priten të miratohen, sigurimin e aksesit të barabartë në drejtësi dhe në regjistrimin civil për pakicat romë dhe egjiptiane, ndërsa respektimi dhe përparimi i të drejtave të pakicave është renditur ndër parimet mbi të cilat bazohet politika e jashtme dhe e fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit.⁵⁵

Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2022 -2024. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023 (PKIE) synon plotësimin e detyrimeve të lindura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (miratuar me ligjin nr. 9590/2006), koordinimin e procesit të përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së si dhe reflekton fazën e hapjes së negociatave të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian. Përafrimi i legjislacionit realizohet përmes një cikli të vazhdueshëm, i cili përfshin (a) studimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, (b) identifikimin e mangësive të legjislacionit shqiptar kundrejt *acquis*, (c) hartimin e akteve shqiptare që synojnë përafrim, dhe (d) monitorimin e zbatimit të legjislacionit të përafruar. Në këtë kuadër, PKIE mundëson koordinimin e këtij procesi duke përcaktuar prioritet etj., aktet që do të përafrohen, ministritë përgjegjëse për hartimin e projektakteve shqiptare, shkallën e përafrimit, afatet e miratimit dhe hyrjes në fuqi si dhe koston e hartimit të legjislacionit të përafruar. Në fushën e mbrojtjes së pakicave kombëtare, Plani thekson rolin e Komitetit të Pakicave Kombëtare në hartimin e projektvendimeve për zbatimin e ligjit nr. 97/2017 dhe nevojën për përfundimin e procesit të konsultimit ndërinstitucional me Ministritë e linjës dhe miratimit të akteve ende të pamiratura nga Këshilli i Ministrave.⁵⁶

Strategjia Kombëtare të Arsimit 2021-2026. Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka hartuar Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, e cila integron sektorët e arsimit parauniversitar dhe të arsimit të lartë dhe është në koherencë të plotë me objektivat strategjikë të kornizës evropiane për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit, si dhe me objektivin OZHQ 4, të Agjendës 2030, për Zhvillim të Qëndrueshëm. Strategjia synon ndërtimin e një sistemi arsimor cilësor, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt, bazuar në diversitetin e tyre. Gjithëpërfshirja është parakusht i domosdoshëm për të siguruar zhvillimin e të gjithë individëve deri në potencialin e plotë të tyre dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale.⁵⁷ Në bazë të ligjit, personave, të cilët u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore. Gjithashtu, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë dhe të kulturës shqiptare, për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë.

Siç raportohet, në kuadër të reformës së arsimit parauniversitar, MASR ka hartuar planin e ri mësimor për pakicat kombëtare dhe ka përgatitur programet mësimore të kurrikulës, në përshtatje me këtë plan mësimor.⁵⁸ Megjithatë, dokumenti thekson se mësimi i historisë/kulturës së romëve nuk është i përfshirë sa duhet në lëndë të ndryshme shkollore, të tilla si: historia, edukimi qytetar ose shoqëror, letërsia, feja ose etika, arti, muzika ose gjuhët. Krahas hartimit të teksteve të reja në gjuhët e pakicave (kryesisht asaj greke dhe maqedonase), të gjithë nxënësit e pakicave kombëtare që ndjekin arsimin bazë në institucionet

⁵⁵ Shih listën e plotë të strategjive sektorale dhe ndërsektorale në shtojcën e SKZHI III.

⁵⁶ Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2022 -2024.

⁵⁷ Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 miratuar me VKM Nr. 621 date 22.10.2021.

⁵⁸ Urdhri I MASR nr. 186, datë 15.5.2015, “Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare”,

arsimore publike pajisen me tekste shkollore falas buxheti i shtetit.⁵⁹ Ndërkohe, nisma “Shkolla, qendër komunitare” (ShQK) e zbatuar në 270 shkolla në partneritet me agjenci dhe organizata jo-qeveritare, duke nisur prej 2013 ka shërbyer jo vetëm për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe të nxënësve, por edhe për hapjen e shkollës ndaj komunitetit të prindërve dhe më gjerë si një shkollë miqësore për të gjithë. Riorganizimi i njësive arsimore vendore i vitit 2019 i kushtoi rëndësi të veçantë mbulimit nga zyra vendore arsimore parauniversitare (ZVAP) të institucioneve arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare (kryesisht ne Finiq-Dropull, Gjirokastër-Libohovë, Sarandë-Delvina-Konispol, Korçë-Pustec), që t’u sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbim arsimor cilësor. Në mënyrë të veçantë, Objektivi specifik A.1 parashikon Aksesin në arsim dhe Objektivi specifik A.2 Mjedisi i sigurt dhe mbështetës i shkollës, thekson se kujdes do t’u kushtohet, ndër grupeve të tjera, edhe vajzave dhe djemve pjesëtarë të pakicave kombëtare romë dhe egjiptiane.

Strategjia Kombëtare Kulturore (2019–2025). SKK përmban 5 objektiva strategjike të tilla si: (1) Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës; (2) Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve të rehabilituara; (3) Promovimi i vlerave të artit dhe të trashëgimisë kulturore; (4) Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, të produkteve, si dhe të cilësisë artistike, (5) Ndërtimi i publikut/zhvillimi i audiencës.

Lidhur me ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të pakicave kombëtare në vend përcaktohet mbështetja financiare e aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe studimore të kësaj trashëgimie me synim mbrojtjen dhe katalogimin e digjitalizimin për ruajtje të kulturës e identitetit të pakicave kombëtare dhe ndalimin e praktikave, që synojnë asimilimin e kulturës dhe të identitetit të tyre të dallueshëm. Ky aktivitet realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Pakicave Kombëtare. Strategjia parashikon gjithashtu programin ‘Edukimi përmes kulturës’ i cili synon të krijojë kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen, katalogimin e digjitalizimin, dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare. Për veprat e trashëgimisë kulturore jomateriale të cilat konsiderohen në rrezik do të bëhet fillimisht përfshirja e tyre në regjistrin e mbartësve të trashëgimisë jomateriale ndërsa përmes skemave të mbështetjes financiare si dhe trajnimeve do të mundësohet transferimi i njohurive nga artizanët dhe zejtarët me përvojë të grupet e ndryshme të interesit.

Numri i hulumtimeve dhe publikimeve për trashëgiminë kulturore të pakicave kombëtare, (faqe 28-29); si dhe numri i aktiviteteve për promovimin dhe mbrojtjen e traditave, kulturës dhe identitetit kulturor të pakicave kombëtare në veçanti (faqe 31), janë ndër treguesit kryesor të rezultateve të pritshme. Po ashtu, integrimi i personave të pakicave kombëtare përmes programit ‘Edukimi Përmes Kulturës’ është një nga masat e ndërmarra që zbatohet si përmes projekteve ekzistuese ashtu edhe nëpërmjet projekteve të hartuara enkas për qasjen sipas nevojave të komuniteteve. Në përmbajtje programi parashikon dhe krijon kushtet e nevojshme për ruajtjen, promovimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës e të identitetit të personave që u përkasin pakicave kombëtare si pasuri, vlerë dhe pjesë të trashëgimisë kulturore kombëtare. Përgatitja dhe publikimi i raporteve të monitorimit dhe vlerësimit do të ndikojë në vazhdimësi në përmirësimin dhe përditësimin e projekteve të programit të edukimit duke iu përshtatur kushteve në terren, si dhe rrethanave në të cilat zhvillohen (faqe 32). Strategjia, thekson se për periudhën 2019-2025 përveç buxhetit të Ministrisë së Kulturës janë parashikuar jo vetëm financimet nga buxhetet e

⁵⁹ Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 17.6.2020, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, janë edhe 18 kategori që përfitojnë tekstet shkollore falas, si: nxënësit që në arsimin parauniversitar i përkasin kategorisë së pakicave kombëtare”.

institucioneve qendrore dhe vendore, veprimtaria e të cilave ndikon direkt apo indirekt në sektorin e kulturës, por edhe financimet nga Bashkimi Evropian dhe donatorët e ndryshëm (faqe 33, 34).

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025. Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve (PKVBPPRE) 2021–2025, është një dokument strategjik që parashikon politika të veçanta për pakicat rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë. Dokumenti është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2021-2030, që është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe siguron përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritimit evropian.

Plani përmban qëllimet e politikave dhe objektivat në 7 qëllime strategjike: 1. Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët. 2. Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale. 3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis Romëve dhe Egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë. 4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore. 5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët. 6. Përmirësimi i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianeve në programet e mbrojtjes sociale. 7. Lufta kundër *antixhipsizmit* (diskriminimi racial ndaj romëve dhe egjiptianëve) në politikat publike si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane. Vlen të theksohet se lufta kundër antixhipsizmit përfshihet për herë të parë ndër qëllimet e Planit të Veprimit.⁶⁰

Në nivel vendor, janë miratuar në disa bashki të vendit planet vendore të zhvillimit për pakicat rome dhe egjiptiane, të cilat adresojnë fusha prioritare për përfshirjen dhe integrim në fusha të tilla si punësimi, strehimi, kujdesi shëndetësor, shërbimet publike, mbrojtja sociale dhe regjistrimi civil.⁶¹

1.4 Korniza Institucionale

Korniza institucionale është mjaft e larmishme dhe përfshin krahas strukturave të institucioneve ekzekutive dhe administrative, në nivel qendror dhe vendor, edhe struktura të pavarura shtetërore e jo qeveritare.

Komiteti është organ këshillimor në varësi të Kryeministrit i cili në përbërjen e tij ka kryetarin, nënkryetarin, anëtarët përfaqësues të pakicave si dhe administratën.

Struktura të ndryshme mbulojnë çështje me interes për pakicat, përfshirë Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe INSTAT-in.

Për më tepër, disa institucionet publike kanë programe buxhetore me ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në fushën e pakicave kombëtare. Këto institucione janë:

⁶⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025.

⁶¹ Shih Planet Vendore që kanë miratuar bashkitë me ndihmën e KiE/Romacted, UNDP-së, etj.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë: Ofron mbështetje për zhvillim ekonomik, mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësisë intelektuale, arsimit profesional, dhe tregu i punës;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë: Përgjegjëse për arsimin e detyrueshëm, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin universitar.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: Fokuset tek zhvillimi i turizmit; -.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme: Lehtëson mbështetjen e shqiptarëve jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në zhvillimet e vendit.
- Ministria e Bujqësisë: Përqendrohet tek zhvillimi rural.
- Bashkitë: Kontribuojnë në arsim, art, kulturë, e sport.

Gjithashtu, struktura institucionale përfshin edhe rrjetin e organizatave të shoqërisë civile të pakicave kombëtare. Këto organizata zotërojnë përvojë dhe ekspertizë të vlefshme, si dhe akses në komunitetet përkatëse, duke qenë kështu një aktor me rëndësi në kornizën e përgjithshme institucionale.

II. Planifikim Strategjik

2.1 Vështrim i Përgjithshëm mbi Planifikimin Strategjik

2.1.1 Konteksti Normativ dhe Shoqëror – Misioni dhe Vizioni

Misioni

Misioni i KPK-së është të garantojë sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, sipas Ligjit Nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Komiteti përmbush misionin e tij duke rekomanduar akte ligjore e nënligjore, politika dhe programe, promovuar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, adresuar çështje të lidhura me pakicat, monitoruar zbatimin e legjislacionit, përgatitur raporte, dhënë kontribut në raportet e institucioneve të tjera, asistuar në plotësimin e angazhimeve që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, dhënë opinione mbi marrëveshjet ndërkombëtare, ngritur ndërgjegjësim publik dhe financuar iniciativa që mbrojnë dhe promovojnë identitetin kombëtar, gjuhësor dhe kulturor të pakicave kombëtare, apo edhe duke trajtuar njohjen e pakicave të tjera.

Ky mision reflekton parashikimet e Nenit 19 të Ligjit 96/2017, i cili i jep KPK-së këto kompetenca:

- a) rekomandon dhe jep opinionin e tij në lidhje me **hartimin e legjislacionit, politikave dhe programeve** që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave kombëtare;
- b) nxit më tej **pjesëmarrjen e personave, që u përkasin pakicave kombëtare në jetën publike** si dhe sugjeron **masa për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave e të lirive** të këtyre pakicave kombëtare;
- c) propozon **rekomandime** për Këshillin e Ministrave, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe organet e pushtetit vendor **për trajtimin e çështjeve që lidhen me pakicat kombëtare**;
- ç) përgatit dhe dorëzon **raporte periodike për Kuvendin** për gjendjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë;
- d) bashkëpunon dhe koordinon me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor raportimin dhe **monitorimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave shtetërore** në lidhje me pakicat kombëtare;

dh) **organizon aktivitete, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin** për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe **forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare**;

e) kontribuon në **përgatitjen e raportit kombëtar për zbatimin e Konventës Kuadër** për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

ë) ndërmer **aktivitete, të cilat kanë si synim përmbushjen e angazhimeve** dhe detyrimeve ndërkombëtare;

f) jep **opinione në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat dhe liritë** e pakicave kombëtare;

g) **jep opinion** pranë institucionit të parashikuar në pikën 3, të nenit 3, të këtij ligji, **lidhur me kërkesat për njohjen e pakicave**;

gj) **financon, nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare, nismat dhe projektet** që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të pakicave kombëtare

Vizioni

KPK, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, zotëron dhe ruan kapacitete të larta institucionale dhe jep kontributin e tij për të nxitur një shoqëri shqiptare gjithëpërfshirë dhe harmonike ku diversiteti kremtohet, dhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare respektohen dhe mbrohen nga institucionet publike, në përputhje me standardet kushtetuese dhe praktikrat më të mirat europiane.

2.1.2 Qëllimet Strategjike, Objektivat Specifike dhe Masat për Zbatimin e Strategjisë

Qëllimi 1: Fuqizimi institucional dhe kapaciteteve organizative për të rritur efektivitetin dhe efikasitetin e KPK-së.

Objektivi 1.1: Pajisja e të gjithë anëtarëve/stafit me njohuri të përshtatshme mbi mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare dhe punën e KPK-së, duke përfshirë, ndër të tjera, përditësime të kornizës normative, praktikrat e punës dhe metodologjinë e komunikimit në përputhje me misionin dhe vizionin e KPK-së.

Masat:

1.1.1. Përgatitja e një pakete orientuese gjithëpërfshirëse për anëtarët apo stafin e ri të institucionit.

1.1.2. Organizimi i takimeve të vazhdueshme midis anëtarëve/stafit administrativ për përditësimin me praktikrat e punës me institucionet homologe në vendet e rajonit.

1.1.3 Pjesëmarrje e vazhdueshme e anëtarëve të KPK-së në konferenca, workshope dhe trajnime të ndryshme që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe veçanërisht për çështjet që lidhen me pakicat kombëtare.

Objektivi 1.2: Përf forcimi i kapaciteteve të KPK-së në fushën e teknologjisë (IT) dhe marrëdhënieve me publikun (PR)

Masat:

1.2.1 Përgatitja, dorëzimi dhe ndjekja e vazhdueshme kërkesës/ kërkesave për mjedise të përshtatshme pune dhe pajisje e mjete zyrash, drejtuar Ministrisë së Financave, Departamentit të Administratës Publike, Kryeministrit dhe/ose organizatave partnere.

1.2.2. Përgatitja, dorëzimi dhe ndjekja e vazhdueshme e kërkesës/ kërkesave për shtimin në organikën e KPK-së së një specialisti IT dhe një specialisti për marrëdhënie me publikun PR drejtuar Ministrisë së Financave, Departamentit të Administratës Publike, Kryeministrit dhe/ose organizatave partnere.

Objektivi 1.3: Ngritja e kapaciteteve për shkrim dhe vlerësim projektsh dhe ngritje fondesh.

Masat:

1.3.1. Pjesëmarrje e vazhdueshme e stafit të Drejtorisë së Analizave dhe Projekteve në konferenca, workshope dhe trajnime të ndryshme mbi ciklin e projekteve dhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht për çështjet që lidhen me pakicat kombëtare

1.3.2. Shkrimi i projekt-propozimeve me qëllim mbështetjen/ngritjen e fondeve për aktivitete tematike të KPK-së.

Qëllimi 2: *Avancimi i përmbushjes së të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare përmes veprimtarive të ndërmarra dhe/ose të mbështetura nga KPK.*

Objektivi 2.1: Sigurimi i financimeve dhe mbështetjes institucionale përmes aplikimit për grante projektsh apo marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata partnere që ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose institucionale me qëllim financimin/mbështetjen e veprimtarive të KPK-së.

Masat:

2.1.1. Krijimi i një hartëzimi / rrjeti për bashkëpunime me institucione dhe partnerë potencialë si BE, KiE, OSBE, agjenci të OKB-së ambasada të vendeve të zhvilluara në vendin tonë, etj.

2.1.2. Lidhja e marrëveshjeve dhe/ose komunikime të dakordësuara, kur është e mundur, me institucione të tjera shqiptare dhe/ ose ndërkombëtare që sigurojnë mbështetje financiare dhe/ose institucionale me qëllim financimin/mbështetjen e veprimtarive të KPK-së.

2.1.3. Identifikimi i thirrjeve për projekte që ofrojnë mbështetje financiare me qëllim financimin e veprimtarive të KPK-së.

2.1.4. Aplikimi aty ku është e mundur në thirrje për projekte që ofrojnë mbështetje (financiare, etj.) me qëllim financimin/realizimin e veprimtarive të KPK-së.

Objektivi 2.2: Mbështetje e vazhdueshme e projekteve/nismave me qasje komunitare dhe institucionale në kuadër të përmbushjes së të drejtave të pakicave kombëtarë si dhe promovimin e diversitetit kulturor në Shqipëri, si dhe monitorimi i progresit dhe vlerësimi i vazhdueshëm i impaktit të tyre.

Masat:

2.2.1 Përgatitja e Raporteve Vjetore të Vlerësimit të Nevojave të Pakicave/Analizë Vjetore për përmbushjen e objektivave të projekteve të financuara nga Fondi.

2.2.2 Përgatitja e *relacionit vjetor* që shoqëron kërkesën për çeljen e Fondit për Pakicat Kombëtare

2.2.3 Përgatitja e *programit vjetor* për pjesëmarrjen e pakicave në procedurë konkurrimi për financimin e granteve.

2.2.4 Hapja e thirrjes dhe përzgjedhja e projekt-propozime që financohen nga Fondi për Pakicat Kombëtare.

2.2.5 Nënshkrimi dhe protokollimi i kontratave midis Kryetarit të KPK-së dhe fituesit përkatës.

2.2.6 Monitorimi i zbatimit të projekteve dhe aktiviteteve të financuara nga Komiteti.

2.2.7 Shpërndarja e fondit të granteve subjekteve të nismave/projekteve fituese.

2.2.8. Realizimi i raporteve vlerësuese për impaktin e nismave/projekteve të realizuara me mbështetjen nga Fondi i KPK-së apo thirrje të ndryshme.

Qëllimi 3: *Dhënia e kontributit profesional në përmirësimin e kornizës ligjore, asaj politike, si dhe praktikave të punës që synojnë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare si dhe adresimin e çështjeve të veçanta të tyre, bazuar mbi praktikën më të mira europiane.*

Objektivi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi sipas nevojës (me ndihmën e organizatave partnere) i ekspertëve të pavarur dhe/ose personave burimorë që mbështesin KPK-në në interpretimin dhe zbatimin e duhur të kuadrit ligjor e nënligjor mbi pakicat.

Masat:

3.1.1. Identifikimi dhe vendosja e kontakteve me ekspertë të pavarur dhe / ose persona burimorë që janë specialistë në fushën e pakicave kombëtare.

3.1.2. Angazhimi kur është e nevojshme (kryesisht përmes mbështetjes nga organizatat partnere), të ekspertëve dhe/ose personave burimorë që janë specialist në fushën e pakicave kombëtare.

Objektivi 3.2: Dokumentimi i veprimtarisë së KPK-së në raporte dhe bërja e tyre e aksesueshme përmes publikimit dhe shpërndarjes së tyre në shqip (sipas mundësive financiare edhe në anglisht, dhe në gjuhët e pakicave).

Masat:

3.2.1. Hartimi i raporteve/relacioneve që pasqyrojnë punën e strukturave të KPK-së.

3.2.2. Përkthimi i materialeve relevante në gjuhën angleze dhe në gjuhët e pakicave për aq sa është e mundur me ndihmën edhe të organizatave partnere.

3.2.3. Publikimi i materialeve relevante në webfaqen (rrjetet sociale) e KPK-së.

3.2.4. Shpërndarja e materialeve relevante që dokumentojnë punën e KPK-së përmes mediumeve të tjera të komunikimit (media sociale, media tradicionale etj.).

Qëllimi 4: *Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional për raportimin dhe monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave që u përkasin pakicave kombëtare.*

Objektivi. 4.1: Bashkërendimi i punës midis KPK-së dhe institucioneve relevante (p.sh. KMD, Avokati i Popullit, KQZ, ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore etj.) në nivelin programatik për mbrojtjen e pakicave nga diskriminimi dhe përmbushjen e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Masat:

4.1.1. Angazhim në komunikim të vazhdueshëm sipas nevojës dhe/ose përpara hartimit të planeve vjetore të punës të KPK-së me institucionet relevante (KMD, Avokati i Popullit, KQZ, ministritë e linjës dhe

bashkitë/njësitë e qeverisjes vendore ku ka përqendrim të lartë të pakicave kombëtare) lidhur me të drejtat e pakicave apo çështje me interes për personat që u përkasin pakicave.

4.1.2. Pjesëmarrja sipas nevojës në tryeza diskutimi dhe aktivitet që organizojnë institucionet relevante për çështjet që lidhen me të drejtat e pakicave kombëtare.

4.1.3. Kërkimi i informacionit zyrtar nga institucionet relevante për politikat që hartojnë dhe masat që marrin për çështjet që lidhen me të drejtat e pakicave kombëtare.

4.1.4. Përgatitja dhe dërgimi i opinioneve, propozimeve dhe rekomandimeve, në institucionet relevante për politika që hartojnë dhe masat që marrin apo për politika të reja që duhen hartuar dhe/ose masa që duhen marrë për çështjet që lidhen me të drejtat e pakicave kombëtare.

Objektivi 4.2: Bashkërendimi i punës midis KPK dhe përfaqësive ndërkombëtare në Shqipëri (KiE, OSBE, UN, ambasadat e vendeve të ndryshme) në nivelin programatik për mbrojtjen e pakicave nga diskriminimi dhe përmbushjen e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Masat:

4.2.1. Angazhim në komunikim të vazhdueshëm dhe konsultime sipas nevojës dhe/ose përpara hartimit të planeve vjetore të punës së KPK-së me përfaqësitë e huaja në Shqipëri si: BE, KiE, OSBE, UN, ambasadat e vendeve të ndryshme, etj., për promovimin e KPK-së dhe bashkërendimin e programimit vjetor të saj me partnerët ndërkombëtarë.

4.2.2. Pjesëmarrje në tryeza diskutimi dhe aktivitetet që organizojnë përfaqësitë e huaja në Shqipëri për çështjet që lidhen me pakicat kombëtare, në varësi të ftesave të marra nga KPK.

Qëllimi 5: Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi rolin dhe veprimtarinë e KPK-së si dhe promovimi i dialogut institucional midis KPK-së dhe pakicave kombëtare.

Objektivi 5.1: Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese / aktivitete të realizuara mbi rolin e KPK-së si dhe të drejtat dhe interesat e pakicave kombëtare në Shqipëri, i cili reflekton jo vetëm kuadrin ligjor dhe institucional, por edhe praktikën më të mirë.

Masat:

5.1.1. Përgatitja e materialeve/aktiviteteteve informuese mbi rolin dhe funksionet e KPK-së.

5.1.2. Shpërndarja e materialeve informuese /aktivitete të realizuara për KPK-së dhe të drejtat e pakicave kombëtare në Shqipëri të grupet e interesit (shoqatat e pakicave kombëtare, institucionet relevante, përfaqësitë e huaja në Shqipëri, etj.).

Objektivi 5.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i popullsisë së shumicës dhe asaj të pakicave kombëtare mbi rolin e KPK-së, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare, si dhe ngritja dhe ruajtja e dialogut institucional mes KPK-së dhe pakicave kombëtare.

Masat:

5.2.1. Organizimi i takimeve informues për rolin e KPK-së (si institucion në varësi të Kryeministrit dhe të drejtat e pakicave kombëtare me grupet e interesit (organizatat e pakicave kombëtare, institucionet relevante, përfaqësitë e huaja në Shqipëri etj.).

5.2.2. Promovimi i aktiviteteve të organizuara nga KPK ose aktivitetet ku KPK merr pjesë për çështjet që lidhen me pakicat kombëtare, në web-faqet zyrtare, rrjetet sociale, broshura, dhe median e shkruar e të audiovizive.

5.2.3. Organizimi sistematik i takimeve që synojnë ngritjen dhe ruajtjen e dialogut institucional mes KPK-së dhe pakicave kombëtare (përmes përfaqësuesve të tyre).

III. Zbatimi, Raportimi, Monitorimi dhe Llogaridhënia

3.1 Strukturat përgjegjëse

KPK, duke përfshirë drejtuesit e institucionit, anëtarët përfaqësues dhe administratën, është përgjegjës për zbatimin e Planit Strategjik 2023-2026. Për përmbushjen e detyrave të caktuara do të krijohen edhe grupe pune specifike. Sipas nevojës dhe me mbështetjen e organizatave partnere, KPK do të synojnë të angazhojë edhe ekspertë dhe/ose persona burimorë me qëllim përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Strategjik. Në këtë kuadër, nevojitet thellimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare apo agjenci donatore. Krahas bashkëpunimit të KPK-së me institucionet tjera publike dhe organizatat donatore, një kontribut të pazëvendësueshëm në zbatimin e këtij plani strategjik mund ta japin Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) vendase dhe të huaja, të cilat adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë problematika që lidhen me të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare.

3.2 Mekanizmat e monitorimit

Me qëllim që ky plan strategjik të mbetet i orientuar drejt arritjes së objektivave, duke gjetur përgjigjet e duhura ndaj sfidave, ai duhet të përshtatet vazhdimisht. Gjithashtu, është e nevojshme që plani të zëbërthet në plane vjetore të cilat parashikojmë ndërhyrje më specifike dhe që mund të përshtaten më lehtë zhvillimeve reale.

KPK do të caktojë një grup koordinues të përbërë nga anëtarë përfaqësues dhe drejtues të administratës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të strategjisë, duke hartuar modele periodike dhe specifike për raportimin e aktiviteteve, si dhe duke këshilluar mbi nxjerrjen e përfundimeve të rezultateve dhe rishikimin e planit strategjik në të ardhmen.

3.3 Raportimi i Progresit

Monitorimi do të realizohet përmes gjurmimit të progresit ndaj zbatimit të masave sipas objektivave përkatës, duke parë kontributin e tyre tek treguesit të cilët masin efikasitetin dhe efektivitetin, afatet kohore dhe standardet e cilësisë.

Për të lehtësuar monitorimin ky plan strategjik përmban tregues sasiore dhe cilësore për secilin objektiv strategjik, afatet e zbatimit të çdo veprimtarie, parashikimin e burimeve financiare të alokuara nga institucioni dhe nevojat për financim nga partnerë të jashtëm, si dhe një listë treguese partnerësh të mundshëm për financimin e aktiviteteve të veçanta.

3.4 Vlerësim i Progresit

Me qëllim vlerësimin e progresit propozohet përgatitja e raporteve vjetore dhe analiza përfundimtare. Për këtë qëllim, Komiteti me ndihmën e organizatave partnere mund të angazhojë, sipas nevojës, ekspertë të jashtëm dhe/ose persona burimorë me përvojë në hartimin e raporteve vlerësuese në fushën e pakicave kombëtare. Kategoritë e treguesve të rezultateve dhe treguesve të performancës, siç janë përshkruar në seksionin 3.5 më poshtë, do të udhëheqin këtë proces.

3.5 Treguesit e Rezultateve dhe Performancës

Plani Strategjik përmban tre lloje treguesish të cilat përfshijnë: treguesit e impaktit për secilin qëllim, treguesit kryesorë të performancës për secilin objektiv, dhe treguesit për secilin aktivitet. Më poshtë janë përfshirë vetëm treguesit e impaktit dhe treguesit kryesorë të performancës. Treguesit për secilin aktivitet gjenden tek matrica e plan-veprimit të këtij dokumenti.

Treguesit e ndikimit apo të impaktit (Outcome Indicators - OIs) masin rezultatet përfundimtare ose ndikimin e veprimtarisë së një institucioni. Ato ofrojnë një perspektivë të gjerë për suksesin apo efektshmërinë e përgjithshme të masave të ndërmarra. Treguesit e impaktit zakonisht janë në përputhje me qëllimet, misionin dhe objektivat afatgjata të institucionit. Këta tregues shpesh vlerësojnë rezultatet përfundimtare ose ndryshimet që ndodhin si rezultat i përpjekjeve të institucionit.

Treguesit kryesorë të performancës (Key Performance Indicators - KPIs), nga ana tjetër, janë më specifik dhe përdoren për të vlerësuar kryerjen e proceseve, aktiviteteve apo drejtimet e caktuara në veprimtarinë e një institucioni. Zakonisht këta tregues janë të lidhur me objektivat specifike dhe janë të matshëm dhe të gjurmueshëm në kohë. Treguesit kryesorë të performancës përdoren për të monitoruar progresin dhe ndihmojnë në marrjen e vendimeve të informuara për të përmirësuar përmbushjen e objektivave.

Më poshtë vijojnë treguesit e impaktit (Outcome Indicators - OIs) për secilin prej qëllimeve dhe treguesit kryesorë për performancën (Key Performance Indicators - KPIs) për secilin objektiv.

1. Forcimi i kapaciteteve institucionale të Komitetit

Treguesit e impaktit:

1. Niveli i buxhetit të alokuar dhe/ose siguruar dhe përdorimi efikas i tij për programet e trajnimit dhe ngritjen e kapaciteteve për stafin e KPK-së.
2. Performancë e përmirësuar në raport me: numrin dhe llojet e njohurive/ aftësive të përfituara nga KPK-ja; mjedise dhe pajisje të përshtatshme pune; dhe menaxhimin efektiv të çështjeve lidhur me teknologjinë e informacionit dhe marrëdhëniet me publikun.
3. Problematika/çështje të zgjidhura dhe arritje për pakicat si rezultat i vendim-marrjeve apo rekomandimeve nga KPK (p.sh çështje arsimore, gjuhësore, pjesëmarrjeje, ndërkulturore, punësime, etj.)

Objektivi 1.1: Sigurimi i njohurive të përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare dhe punën e KPK-së për të gjithë anëtarët dhe stafin, duke përfshirë përditësimin e kornizën e përditësuar normative, praktikave të punës dhe metodave të komunikimit në përputhje me misionin dhe vizionin e KPK-së.

Treguesit e Performancës:

- Përqindja e anëtarëve dhe stafit të KPK-së me nivel të përmirësuar të njohurive mbi të drejtat dhe interesat e pakicave kombëtare dhe punën e KPK-së.
- Rregulloret e praktikave të punës dhe metodat e komunikimit të rishikuara/përditësuara e përshtatura me misionin dhe vizionin e KPK-së.

Objektivi 1.2: Përforsimi i kapaciteteve të KPK -së në fushën e administrimit të teknologjisë informative (TI) dhe marrëdhëniet me publikun (PR).

Treguesit e Performancës:

- Numri i specialistëve të rekrutuar nga KPK-ja në fushën e PR and IT.
- Numri i fushatave apo iniciativave të suksesshme në marrëdhëniet me publikun të zhvilluara nga KPK-ja.

Objektivi 1.3: Forcimi i kapaciteteve për shkrimin dhe vlerësimin e projekteve dhe ngritjen e fondeve.

Treguesit e Performancës:

- Numri i anëtarëve të stafit të trajnuar dhe niveli i ndryshuar i njohurive të tyre për shkrim, vlerësim projektësh, dhe ngritje fondesh.
- Numri i projekteve të shkruara nga KPK për aplikim.

2. Përmirësimi i përmbushjes së të drejtave:**Treguesit e Impaktit:**

1. Numri dhe llojet e bashkëpunimeve me organizatat donatore dhe atyre me përvojë në fushën e pakicave dhe të drejtave të njeriut
2. Ndryshimet e sjella si pasojë e aktiviteteve të KPK-së dhe perceptimi pozitiv i tyre nga komunitetet e pakicave kombëtare
3. Situata e përmirësuar e pakicave në vend kryesisht përmes rritjes së rasteve ku të drejtat e pakicave mbrohen dhe zbatohen

Objektivi 2.1: Sigurimi i fondeve dhe mbështetjes institucionale duke aplikuar për grantet e projekteve ose bashkëpunuar me organizata partnere që mund të ofrojnë mbështetje financiare dhe/ose institucionale për aktivitetet e KPK-së.

Treguesit e Performancës:

- Numri i granteve dhe shuma e siguruar nga aplikimet e suksesshme.
- Niveli i mbështetjes institucionale që KPK-ja ka marrë nga organizatat partnere.

Objektivi 2.2: Mbështetja e vazhdueshme e projekteve dhe iniciativave që zbatojnë qasje komunitare dhe institucionale, të cilat promovojnë përmbushjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe diversitetin kulturor në Shqipëri, duke monitoruar progresin dhe vlerësuar ndikimin e tyre.

Treguesit e Performancës:

- Numri i projekteve të orientuara nga komuniteti dhe institucionet që mbështeten nga KPK-ja.
- Vlerësimi i ndikimit të projekteve të mbështetura nga KPK-ja në plotësimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe nxitjen e diversitetit kulturor.

3. Përmirësimi i kornizave ligjore politikave dhe qasjeve:**Treguesit e Impaktit:**

1. Akte ligjore/nënligjore, politika, qasje dhe/ose praktika pune të miratuara apo vënë në zbatim me pjesëmarrjen/kontributin profesional edhe nga KPK-ja.
2. Shkalla e përputhshmërisë së legjislacionit dhe politikave kombëtare me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira evropiane.

3. Niveli i përmbushjes së pritshmërive të grupeve të interesit nga kontributi profesional i KPK-së.

Objektivi 3.1: Identifikimi dhe angazhimi i ekspertëve të pavarur dhe/ose personave burimorë, me ndihmën e organizatave partnerë, për të mbështetur KPK-në në interpretimin dhe zbatimin e duhur të kornizave ligjore dhe nënligjore lidhur me pakicat kombëtare.

Treguesit e Performancës:

- Numri i ekspertëve të pavarur ose personave burimorë të angazhuar nga KPK-ja.
- Numri i herëve të angazhimit të ekspertëve të pavarur ose personave burimor nga KPK-ja.

Objektivi 3.2: Dokumentimi i veprimtarisë të KPK-së në raporte dhe bërja e aksesueshëm përmes publikimeve dhe shpërndarjes në gjuhën shqipe, angleze dhe gjuhët e pakicave.

Treguesit e Performancës:

- Numri i raporteve që dokumentojnë aktivitetet e KPK-së.
- Qasja bazuar në evidence zbatuar në përgatitjen e raporteve të publikuara dhe shpërndara.

4. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit:

Treguesit e impaktit:

1. Lloji dhe numri i rritur i veprimtarive ndërinstitutionale të përbashkëta mes KPK-së dhe institucioneve të tjera me qëllim monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e kornizave ligjore dhe politikave.

2. Marrëdhënie dhe bashkëpunime të përforcuara midis KPK-së dhe organizatave ndërkombëtare (BE, KiE, OSBE, OKB) dhe ambasadave për shkëmbim të praktikave të mira dhe promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare.

3. Ndryshimet e sjella në praktikën e institucioneve me pjesëmarrje dhe angazhim të përfaqësuesve të pakicave në mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional dhe ndikimin pozitiv në jetën e personave që u përkasin pakicave.

Objektivi 4.1: Bashkërendimi i punës së KPK-së me institucionet relevante (p.sh., KMD, Avokati i Popullit, KQZ, ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore) në nivel programor për të mbrojtur pakicat nga diskriminimi dhe për të përmbushur të drejtat e personave që i përkasin pakicave kombëtare.

Treguesit e Performancës:

- Numri i aktiviteteve të koordinuara ose iniciativave të përbashkëta me institucionet relevante.
- Përmirësimi i mbrojtjes nga diskriminimi dhe plotësimi i të drejtave të pakicave kombëtare në bazë të përpjekjeve të përbashkëta.

Objektivi 4.2: Bashkërendimi i punës midis KPK-së dhe përfaqësive ndërkombëtare në Shqipëri (BE, KiE, OSBE, OKB, ambasadat e vendeve të ndryshme) në nivel programatik për të promovuar më tej mbrojtjen e pakicave nga diskriminimi dhe sigurimin e përmbushjes së të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare.

Treguesit e Performancës:

- KPI: Numri i veprimtarive apo angazhimeve të bashkërenduara me përfaqësitë ndërkombëtare.
- KPI: Niveli i njohjes dhe mbështetjes që KPK-ja siguron nga përfaqësitë ndërkombëtare në promovimin e mbrojtjes dhe të drejtave të pakicave kombëtare

5. Informimi dhe ngritja e ndërgjegjësimit:

Treguesit e Impaktit:

1. Niveli i njohjes dhe kuptueshmërisë publike (tek popullsia e shumicës dhe ajo e pakicave) për rolin e KPK-së dhe të drejtave të pakicave.
2. Nivelet e angazhimit dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në veprimtaritë publike të organizuara nga KPK-ja për të promovuar dialogun institucional dhe mirëkuptimin midis pakicave kombëtare dhe popullsisë shumicë.
3. Niveli i mbështetjes dhe qëndrimeve pozitive në popullatën shumicë lidhur me të drejtat dhe diversitetin kulturor të pakicave kombëtare, të dokumentuar në media.

Objektivi 5.1: Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve/aktiviteteve informuese lidhur me rolin e KPK-së, të drejtat dhe interesat e pakicave kombëtare në Shqipëri, duke përfshirë kornizat ligjore dhe institucionale, si dhe praktikën më të mira.

Treguesit e Performancës:

- Numri i materialeve/aktiviteteve informuese të përgatitura dhe të shpërndara.
- Aksesueshmëria dhe ndikimi i materialeve/aktiviteteve në ngritjen e ndërgjegjësimit për rolin e KPK-së dhe të drejtat e pakicave kombëtare.

Objektivi 5.2: Informimi dhe ndërgjegjësimi i popullsisë së shumicës dhe popullsisë së pakicave kombëtare mbi rolin e KPK-së, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pakicave, si dhe ngritja dhe ruajtja e dialogut institucional mes KPK-së dhe pakicave kombëtare.

Treguesit e Performancës:

- Niveli i ndërgjegjësimit tek popullata shumicë rreth rolit të KPK-së dhe të drejtave të pakicave kombëtare.
- Niveli i kënaqësisë tek pakicat kombëtare në lidhje me dialogun institucional dhe mbështetjen e ofruar nga KPK-ja.

IV. Plani i Veprimit dhe Buxheti i Aktiviteteve

(shih dokumentin e matricës)

V. Bibliografia

Raport Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2022.

Raport Vjetor i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2022.

Raport i Avokatit të Popullit (2021). Përgjigje ndaj kërkesës për informacion të Ombudspersonit në kuadër të raportit të të drejtave të njeriut të FRA-s. 27 shtator 2021.

Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI). (2020). Raporti i gjashtë i ECRI-s për Shqipërinë.

Shqipëria. (2021, maj). Raporti i pestë mbi zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

Bashkimi Evropian. (2022). Raporti i Progresit të BE-së 2022 për Shqipërinë.

Komiteti për Minoritete Kombëtare, Drejtoria e Planifikimit dhe Projekteve të KMN-së. (2022, dhjetor). Raporti i Vlerësimit të Nevojave.

Sandor-Szalay, E. (2022, qershor). Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Komitetin e Minoriteteve Kombëtare.

Këshilli i Europës. (2022). Komente mbi raportin e Vlerësimit të Nevojave Institucionale [Komunikim me Email].

Grupi i Punë i KPK-së. (2023, shkurt-qershor). Të dhënat e mbledhura gjatë workshopeve.

Republika e Shqipërisë. (1998). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 8417, i ndryshuar).

Republika e Shqipërisë. (2021). Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (Ligji Nr. 7895/1995, i ndryshuar).

Republika e Shqipërisë. (2020). Ligji Nr. 10221, "Për mbrojtjen nga diskriminimi" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020).

Republika e Shqipërisë. (2009). Ligji Nr. 10129, "Për gjendjen civile" (i ndryshuar).

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2011). Vendimi Nr. 52 (mbi anulimin e termave kombësi nga regjistri civil).

Republika e Shqipërisë. (2008). Ligji Nr. 9887, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Republika e Shqipërisë. (2020). Ligji Nr. 140/2020, "Për censusin e popullsisë dhe banesave".

Republika e Shqipërisë. (2018). Ligji Nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzeumet".

Republika e Shqipërisë. (2013). Ligji Nr. 97/2013, "Për mediumet audio-vizive në RS" (i ndryshuar deri në vitin 2022).

Republika e Shqipërisë. (2000). Ligji Për bibliotekat në RSH.

Republika e Shqipërisë. (2021). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2023 (NSDI III).

Kryetari i KPK-së. (2023, 27 janar). Urdhër mbi krijimin e grupit punues për përgatitjen e planit strategjik për zhvillimin institucional të KMN-së.

Këshilli i Ministrave. (2004, 11 mars). Vendimi Nr. 127, "Për krijimin e komitetit shtetëror për minoritetet".

Zyra e Kryeministrit. (2022, 1 prill). Urdhër Nr. 60, "Për miratimin e strukturës së Komitetit për Minoritete Kombëtare".

Këshilli i Ministrave. (2018, 29 shtator). Vendimi Nr. 561, "Për sigurimin e teksteve shkollore për studentët, trajnimin fillestar, zhvillimin mëtejësor profesional të mësuesve, si dhe për krijimin dhe funksionimin e klasave në gjuhën e minoritetit kombëtar".

Këshilli i Ministrave. (2018, 29 shtator). Vendimi Nr. 562, "Për masat e duhura për promovimin e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimeve fetare të minoriteteve kombëtare në veprimtarinë arsimore dhe shkencore të institucioneve të larta".

Këshilli i Ministrave. (2018, 12 dhjetor). Vendimi Nr. 726, "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Minoritete Kombëtare".

Këshilli i Ministrave. (2019, 17 prill). Vendimi Nr. 227, "Për përgatitjen, publikimin dhe shpërndarjen e teksteve të studentëve që i përkasin minoriteteve kombëtare në sistemin e arsimit themelor".

Këshilli i Ministrave. (2019, 10 maj). Vendimi Nr. 286, "Për miratimin e procedurave për zgjedhjen e kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Minoritete Kombëtare".

Këshilli i Ministrave. (2019, 3 korrik). Vendimi Nr. 462, "Për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e personave që i përkasin minoriteteve kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Republikën e Shqipërisë".

Këshilli i Ministrave. (2019, 3 korrik). Vendimi Nr. 463, "Për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe për krijimin e kushteve të nevojshme që personat që i përkasin minoriteteve kombëtare të përdorin dhe zhvillojnë elementet themelore të identitetit të minoriteteve kombëtare, përfshirë gjuhën e tyre".

Këshilli i Ministrave. (2020, 24 dhjetor). Vendimi Nr. 115, "Për kriteret e përcaktimit të njësisë së vetqeverisjes lokale, numrit themelor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të minoriteteve kombëtare për t'u arsimuar në gjuhën e minoritetit kombëtar".

Këshilli i Ministrave. (2020, 24 dhjetor). Vendimi Nr. 115, "Për kriteret e mbështetjes së iniciativave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar të dallueshëm dhe kriteret e seleksionit për financimin dhe administrimin e fondit për minoritetet kombëtare".

Republika e Shqipërisë. (2017). Ligji Nr. 96/2017.

Kombe të Bashkuara. (1966). Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

Kombe të Bashkuara. (1989). Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

Kombe të Bashkuara. (1992). Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave që i përkasin Minoriteteve Kombëtare, Etnike, Fetare dhe Gjuhësore.

Bashkimi Evropian. (2009). Traktati i Lisbonës.

Parlamenti Evropian. (2018). Rezoluta e 13 nëntorit 2018 për standarde minimale për minoritetet në BE (2018/2036(INI)).

Këshilli i Europës. (1950). Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Protokoli 12).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. (s.a.). Përzgjedhje e vendimeve të rëndësishme për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare.

Këshilli i Europës. (s.a.). Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

Zyra e Komisionerit të Lartë të OSBE-së për Minoritetet Kombëtare. (s.a.). Nëntë Rekomandime dhe Udhëzime.

Zyra e OSBE-së në Tiranë. (2021). Nëntë Rekomandime dhe Udhëzime për kryerjen e Censurit të Popullsisë dhe Banesave.

VI. Shtojca 1: Lista e detajuar e aktiviteteve të zhvilluara nga KPK-ja pas ristrukturimit të marsit 2021

Seminar mbi Dialogun Politik të Përfshirjes së Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri, 20 prill 2022.

Takim pune me Drejtuesin e ri të Departamentit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, z. Cailean Maclean.

Takim konsultativ organizuar nga Ministria për Evropën e Punët e Jashtme për listën e çështjeve dhe pyetjeve në lidhje me raportin e pestë periodik të Shqipërisë të dorëzuar pranë Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave.

Takim me Kryeredaktoren e RTSH 2, znj. Enerjeta Jani Fuga, mbi bashkëpunimin e mëtejshëm në kuadër të ligjit të ri për mbrojtjen e të drejtave, pasqyrimin, promovimin e trashëgimisë kulturore, historikun, gjuhët përkatëse, traditat, aktivitetet dhe takimet e pakicave kombëtare.

Takim me Ministrin për Marrëdhënie me Diasporën pranë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Xhemal Çupi.

Gjatë muajit qershor 2022, anëtarët e KPK, secili prej anëtarëve individualisht, kanë zhvilluar takime konsultative me drejtoreshën e komunikimit të KQZ dhe shefin e sektorit të edukimit të zgjedhësve të këtij institucioni. Në fokus të këtyre takimeve kanë qenë kryesisht përqendrimet e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, problematikat që ata hasin gjatë kohës së zgjedhjeve, mediat që ndiqen më shumë nga anëtarët e pakicave kombëtare e të tjerë.

Aktivitet për pakicat kombëtare nga shoqata AJMI me drejtues z. Shkëlqim Hajno, zhvilluar në Livadhja, Bashkia Finiq, qershor 2022. Aktiviteti u organizua në kuadër të një projekti të financuar nga Ministria e Kulturës.

Takim me Nënkryetarin e Komitetit për Pakicat Kombëtare në Republikën e Kroacisë z. Vladimir Ham i cili është dhe zëvendësprezidenti i FUEN-it (Unioni Federal European i Minoriteteve).

Pjesëmarrje në Dëgjuesën Publike lidhur me "Zbatimin e Ligjit të Arsimit për Pakicat Kombëtare".

Pjesëmarrje në "Takimin Konsultues për Komponentin e Arsimit me Përfaqësuesit e Institucioneve Shtetërore" në kuadër të projektit "Inclusive EduJobs" mbështetur nga Bashkimi Evropian, Inclusive EduJobs, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Bashkia Tirane dhe Organizatën Greke (KMOP).

Pjesëmarje në Tryezën e rrumbullakët nga Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare z. Kairat Abdrakhamanov. Tryeza me temë "Shkëmbimi i eksperiencës për integrim dhe diversitet në qeverisje në zonën e OSBE-së u zhvillua në Hagë të Hollandës.

Pjesëmarrje në aktivitetin hapës të projektit "EU for Inclusive Teaching" (BE-ja për Arsimin Gjithëpërfshirës), i financuar nga Bashkimi Evropian, një nismë e cila synon përmirësimin e të nxënësve cilësorë të gjithëpërfshirës dhe promovimin e arsimimit në sistemin para-universitar, me fokus të veçantë të fëmijët në kushte të pa favorizuara.

Në nëntor të vitit 2022 u financua nga ana e Komitetit, në zbatim të VKM – së përkatëse, projekti me temë “ Promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore të nëntë pakicave kombëtare në Shqipëri’.

Takim me përfaqësues të Komitetit Këshillimor të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, në kuadër të vizitës së tyre për konsultime me palët për përgatitjen e opinionit të pestë për zbatimin e Konventës Kuadër nga Republika e Shqipërisë në muajin nëntor të vitit 2022.

Pjesëmarrja në takimet dypalëshe BE - Shqipëri për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", i cili u mbajt në Bruksel, 25 nëntor 2022.

Pjesëmarrje në edicionin e dytë të Samitit REDI SUMMIT 2022, "Roma Entrepreneurship Development Initiative në panelin e diskutimit të Ballkanit Perëndimor Green Agenda: "Mundësi ose kërcënim për biznesin dhe gjenerimin e punësimit në komunitetet vulnerabël", i cili u zhvillua në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Takim me Raportuesin e Posaçëm mbi të Drejtën për Zhvillim nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), z. Saad Alfarargi në muajin mars të vitit 2023.